



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “ Universiteti Barleti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Dorina Kripa

2. Dr. Valbona Kapllani

Shtator 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me profil
“Kontabilitet” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Barleti
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë me profil Kontabilitet
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 549, datë 11.11.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhëri i MASR Nr.213, datë 03.07.2020
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 95, datë 23.03.2022 (profili "Kontabilitet")
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 604, datë 22.12.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë i studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite akademike /4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 (shtatë) PAE / 5 (pesë) PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 20 (njëzet) studentë; 2020-2021 25 (njëzet e pesë) studentë; 2021-2022 13 (trembëdhjetë) studentë.
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” është hapur me Vendimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 549, datë 11.11.2011. Ky program ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë i Universitetit “Barleti” i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 571, datë 12.08.2005 dhe i riorganizuar në vitin 2019 me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 511, datë 24.10.2019 dhe me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 213, datë 23.07.2020.

Ky program studimi, si pjesë e programit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me disa profile, ka marrë fillimisht vlerësimin e *akreditimit me kusht* nga Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë (KA), me vendimin Nr. 67, datë 27.07.2015. Më pas, me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 604, datë 22.12.2016, programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me disa profile është akredituar sipas të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që buronin nga kuadri ligjor në fuqi, pasi me vendimin Nr.207, datë 18.11.2016 të KA janë konsideruar të plotësuar kushtet për akreditim të vendosura në vendimin e mëparshëm të KA.

Universiteti “Barleti” është i organizuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.80/2015 në tri¹ njësi kryesore:

- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative;
- Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë;
- Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit.

Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, është njësi bazë përgjegjëse që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, si pjesë e fushës së kontabilitetit dhe financës. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky program është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale dy vite akademike (katër semestra), në përfundim të të cilit

¹ Në këtë raport, vlerësimi i GVJ i referohet strukturës organizative të UniBa të miratuar sipas Urdhërit të MAS Nr.213, datë 03.07.2020 për riorganizimin institucional të SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” në Universiteti “Barleti”. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që UniBa po përgatitej edhe për hapjen e një njësie kryesore të katërt, Fakultetin e Shkencave Mjekësore.

studentët pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”.

Objektivi kryesor i këtij programi është të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike, si dhe me aftësim për kërkim shkencor në fushën e kontabilitetit. Gjithashtu, ky program synon të formojë studiues dhe njohës të mirë të fushës së kontabilitetit, si dhe profesionistë të aftë për të analizuar sfidat dhe mundësitë që hasin bizneset e ndryshme në mjedisin financiar global.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën datë 25.11.2021, Universiteti “Barleti” ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin periodik të programit të studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017” ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti “Barleti”, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Prof. Dr. Dorina Kripa**, pedagoge në FEUT, Departamenti i Financës dhe **Dr. Valbona Kapllani**, pedagoge në FEUT, Departamenti i Kontabilitetit. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, **Msc. Arjana Alija**.

Në datën 27.01.2023 ekspertëve të jashtëm iu dha në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe axhenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 7 dhe 8 Shkurt 2023 në ambientet e Universitetit “Barleti”. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 15 Shkurt 2023.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”.

Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë e pikave të forta dhe të dobëta të këtij programi studimi. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Ky program studimi, si pjesë e programit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me disa profile ka marrë fillimisht vlerësimin e *akreditimit me kusht* nga Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë (KA), me Vendimin Nr. 67, datë 27.07.2015.

Më pas, me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 604, datë 22.12.2016 programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me disa profile është akredituar sipas të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që buronin nga kuadri ligjor në fuqi, pasi me Vendimin Nr.207, datë 18.11.2016 të Këshillit të Akreditimit janë konsideruar të plotësuar kushtet për akreditim të vendosura në vendimin e mëparshëm të KA.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion GVJ nuk konstatoi rekomandime të lëna për t’u plotësuar nga ky akreditim.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Barleti” (referuar shkurt si “UniBa” në këtë raport vlerësimi) është një Institucion i Arsimit të Lartë i cili angazhohet në ofrimin e programeve të studimit që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. I riorganizuar në vitin 2020 (dikur Shkolla e Lartë Jopublike “Universiteti Marin Barleti”), UniBa e zhvillon veprimtarinë në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me parimet dhe standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë, si dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore duke pasqyruar parimet dhe objektivat e procesit të Bolonjës. Nenet 3-7 të Statutit të UniBa shprehin qartë parimet bazë, misionin, vizionin dhe qëllimet e institucionit si një aktor i zhvillimit të arsimit të lartë cilësor, që ofron vlera profesionalizmi dhe qytetarie përmes një edukimi ndërdisiplinor, inovativ, aplikativ, të orientuar nga tregu i punës duke vendosur studentin në qendër dhe duke zhvilluar bashkëpunime rajonale dhe ndërkombëtare. <i>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te institucional 2020-2030.pdf]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”, i ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë të UniBa, në përgjegjësi të Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës është program i Ciklit të dytë të studimeve, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe me një total prej 120 kredite (ECTS). Ky program studimi synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike si dhe me aftësim për kërkim shkencor në fushën e kontabilitetit dhe financës me profil kontabilitetin. Objektivi është përgatitja e profesionistëve të kontabilitetit, si studiues dhe njohës të mirë të kësaj fushe, të aftë për të analizuar sfidat dhe mundësitë që hasin bizneset e ndryshme në mjedisin global financiar.

	<p>GVJ vlerëson se ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin dhe me fushën e veprimtarisë së UniBa, të shprehur në Statutin dhe në Rregulloren e institucionit.</p> <p>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te institucional 2020-2030.pdf]</p>								
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit (RVB) dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Institucional të UniBa, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit në kushtet e integritimit europian.</p>								
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>UniBa përmes programeve të studimit synon që të përgatisë studentët si profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës të aftë për sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes, por edhe si qytetarë të përgjegjshëm dhe të angazhuar në një botë në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm.</p> <p>GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, përgjegjës për këtë program studimi, ka hartuar edhe një studim tregu dhe një strategji zhvillimi për programet e studimit që mbulon, në të cilat analizohen zhvillimet dhe problematikat në tregun vendas dhe më gjerë lidhur me profesionet në fushën e kontabilitetit dhe financës.</p> <p><i>Megjithatë GVJ rekomandon që studimi i tregut duhet të shoqërohet edhe me një analizë sasiore të dedikuar në funksion të programit përkatës të studimit.</i></p> <p>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 1 Rregullore e FEQD.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te institucional 2020-2030.pdf; Evidenca 5.0 strategjia MSHFK.pdf; Evidenca 5.2 Studim tregu MSHFK.pdf]</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit është hartuar në përputhje me interesat kombëtare të zhvillimit dhe synon të ruajë dhe konsolidojë vlerat akademike dhe kulturore të shoqërisë. - Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin, Statutin dhe Strategjinë e Zhvillimit Institucional të UniBa dhe me fushat e studimit të tij. 								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesësisht				X
	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesësisht						
			X						

Standardi I.2
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret **Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Universiteti “Barleti” (UniBa) i ka fillesat e aktivitetit në Shkollën e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti” të krijuar bazuar në VKM nr.571 të vitit 2005. Struktura aktuale akademike është rezultat i riorganizimit të bërë në vitin 2020, me Vendimin nr.52 të Senatit Akademik të UniBa dhe në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.80/2015. UniBa përbëhet nga tri njësi kryesore:

- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative;
- Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë;
- Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit.

Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD) përbëhet nga:

- Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës;
- Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimi; dhe
- Departamenti i Drejtësisë.

Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel Fakulteti për tre vitet e fundit përbëhet si vijon:

PAE /Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Profesor	2	2	1
Profesor i Asociuar	5	5	4
Doktor/Docent	9	7	10
Msc.	6	10	17
Totali	22	24	32

Programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës (DESF). Në ciklin e parë të studimeve pranë FEQD, ky departament mbulon edhe programet e studimit “Bachelor në Menaxhim Biznesi”, “Bachelor në Financë, Bankë, Sigurime & Pasuri të Paluajtshme” dhe “Bachelor në Marketing, Publicitet & Marrëdhënie me Publikun”. Në ciklin e dytë të studimeve, DESF mbulon programet e studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” dhe “Master Profesional në Administrim Biznesi” me tre profile. Gjithashtu ky departament mbulon edhe programin profesional jo-universitar “Teknik në operacione biznesi, marketing dhe shitje”.

Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel Departamenti përgjegjës për tre vitet e fundit përbëhet si vijon:

PAE /Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Profesor	1	2	1
Profesor i Asociuar	1	2	1
Doktor/Docent	4	3	3
Msc.	1	3	6
Totali	8	10	11

	<p>Nga analiza e informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi disa mospërputhje lidhur me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” dhe pranë Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës. Gjatë vizitës në institucion, GVJ kërkoi si informacion shtesë përditësimin e tabelave me informacion mbi personelin akademik.</p> <p>Nga ky përditësim rezultoi se gjatë vitit akademik 2021-2022, për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej 12 pedagogë nga të cilët 7 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë (PAE) dhe 5 anëtarë të personelit akademik me kontratë (PAK). Gjithashtu për vitin akademik 2021-2022 nga pedagogët e angazhuar në programin e studimit 5 i përkasin kategorisë Profesor, 4 i përkasin kategorisë Lektor dhe mbajnë gradën Doktor, ndërsa 3 pedagogët e tjerë të kategorisë As. Lektor mbajnë kualifikimin Master i Shkencave.</p> <p>Gjatë viteve akademike 2019 – 2021, programi i studimit është realizuar në masën 58% - 78% me personel akademik efektiv (PAE).</p> <p>GVJ konstaton se personeli akademik i këtij departamenti dhe veçanërisht personeli i angazhuar në këtë program studimi zotëron përvojën dhe kryesisht kualifikimet e nevojshme, si dhe disponon kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të ofruar këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11.3 SYLLABUS.pdf; EVIDENCA 23.2 CV STAFI AKADEMIK.pdf; EVIDENCA 27 TABELAT 1 - 24.pdf; Doc. Shtese Tabela personeli akademik ne PS MSH-K.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” është program i ciklit të dytë të studimeve, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, i organizuar me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe me një total prej 120 kredite (ECTS), në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015. Ky program studimi synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike si dhe me aftësim për kërkim shkencor në fushën e kontabilitetit dhe financës me profil kontabilitetin.</p> <p>Fushat akademike e kërkimore të Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës përfshijnë edhe fushën e përgjithshme dhe specifike të këtij programi studimi, që synon përgatitjen e profesionistëve të kontabilitetit, si studiues dhe njohës të mirë të kontabilitetit dhe financës, të aftë për të analizuar sfidat dhe mundësitë që hasin bizneset e ndryshme në mjedisin global financiar</p> <p>Klasifikimi/kodifikimi i elementëve të programit të studimit është bërë në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Por, GVJ konstaton se kuadri rregullator i UniBa është shumë i përgjithshëm lidhur me fushat e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe rekomandon që Rregullorja e Departamentit dhe Rregullorja e Programit të Studimit duhet të plotësohen me përcaktime</p>

	<p>më të plota në funksion të natyrës specifike të programeve të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës.</p> <p>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 1 Rregullore e FEQD.pdf; EVIDENCA 1.3 RREGULLORE DESF.pdf; EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 11.3 SYLLABUS.pdf; EVIDENCA 23.2 CV STAFI AKADEMIK.pdf; EVIDENCA 27 TABELAT 1 - 24.pdf; Doc. Shtese Tabela personeli akademik ne PS MSH-K.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit (RVB) dhe në dokumentacioni shoqërues, GVJ nuk konstaton evidenca mbi trajnime apo kualifikime profesionale për studentët e diplomuar.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se</p> <ul style="list-style-type: none"> - UniBa ka në përgjithësi kapacitetet e duhura për ofrimin e programit të studimit. - Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” është në përputhje me fushën e përgjithshme akademike të njësisë kryesore dhe bazë, por rregulloret e këtyre njësive duhet të përcaktojnë qartë dhe në hollësi fushën akademike të tyre. - UniBa nuk ofron trajnime apo kualifikime profesionale për studentët e diplomuar. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse</p>	<p>Në funksion të realizimit të programeve të tij të studimit, UniBa ka hartuar rregullore, politika, procedura, udhëzues dhe manualë, përmes të cilave mbikëqyr mbarëvajtjen e tyre.</p> <p>Statuti i UniBa përcakton strukturat akademike dhe administrative të organizimit të institucionit dhe garanton bashkëpunimin dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive mes këtyre strukturave. Rregullorja e UniBa, rregullorja e njësisë kryesore, rregullorja e njësisë bazë përcaktojnë</p>

<p>dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të departamentit, personelit akademik si dhe të personelit ndihmës akademik. Përveç punës mësimore dhe kërkimore, personeli akademik angazhohet edhe në detyra administrative.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB, GVJ iu konfirmua se Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes & Drejtësisë dhe Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës kryejnë analiza mbi mësimdhënien dhe aktivitetin kërkimor shkencor të personelit akademik. Institucioni përpiqet që të nxisë bashkëpunimin mes njëjësive dhe personelit akademik nëpërmjet organizimit të konferencave, seminareve, tryezave të rrumbullakta dhe aktiviteteve të tjera në funksion të procesit të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 1 Rregullore e FEQD.pdf; EVIDENCA 1.3 RREGULLORE DESF.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqëruar dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UniBa ka në fokus të punës së tij bashkëpunimet me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit përmes pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta dhe nënshkrimit të një sërë marrëveshjeve për bashkëpunim me interes reciprok.</p> <p>Aktualisht në nivel institucioni (UniBa), janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucione publike vendase dhe sipërmarrje private. Në shërbim të programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” janë lidhur 29 marrëveshje bashkëpunimi kryesisht për realizimin e praktikave profesionale.</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit të Brendshëm.pdf; Evidenca 15. Lista e marreveshjeve të bashkëpunimit.pdf; EVIDENCA 27 TABELAT 1 - 24.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Siç u përmend edhe në kriterin 2 të këtij standardi, GVJ konstaton se UniBa ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale në përgjithësi dhe për këtë program studimi në veçanti, në nivel institucioni kryesisht me institucione publike rajonale dhe sipërmarrje private.</p> <p>Dokumentacioni për praktikën profesionale të programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” përmban të gjithë elementët e nevojshëm për rregullimin e marrëdhënieve mes studentëve, institucionit pritës për realizimin e praktikës dhe UniBa, si dhe një ecuri të suksesshme të praktikës së parashikuar në këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 11.3 SYLLABUS UNIBA PAKETA E PRKTIKES MASTER PRILL 2021.pdf; Evidenca 15. Lista e marreveshjeve të bashkëpunimit.pdf; EVIDENCA 22 TE DHENA TABELORE PER MARREVESHJET E BASHKEPUNIMIT.pdf; EVIDENCA 10 LISTA E</i></p>

	<i>STUDENTEVE DHE E INSTITUCIONEVE KU KANE ZHVILLUAR PRAKTIKEN PROFESIOALE.pdf</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Gjithashtu, bazuar në sa më sipër, GVJ konstatoi se në mbledhjet në mbyllje të vitit akademik, Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës trajton si pjesë të analizës vjetore edhe përfitimet kryesore nga marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura. Rezulton se përfitimet kryesore lidhen me mobilitete të personelit akademik dhe të studentëve, realizim të workshop-eve, trajnimeve dhe leksioneve të hapura, mundësi punësimi për studentët, përveç zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve. <i>Megjithatë GVJ rekomandon që analiza e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duhet të formalizohet si raport i dedikuar në funksion të realizimit të programit të studimit.</i> <i>[Referenca: Doc. Shtese 1.1. Analiza Vjetore DEFS (2 vitet fundit).pdf]</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se - UniBa ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit si dhe me institucione publike dhe private. - UniBa ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale në nivel institucioni kryesisht me institucione publike rajonale dhe sipërmarrje private. - Pjesë e analizës vjetore të Departamentit janë edhe përfitimet kryesore nga marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura, por nuk ka një raport formal të dedikuar të analizës së këtyre përfitimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushje pjessisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushje pjessisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X
---	-----------------------------	-----------------------------	------------------------------	----------

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” është hapur me Vendimin e MASH, Nr. 549, datë 11.11.2011 fillimisht si një nga katër profilet e parashikura të këtij programi master. Ai organizohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, në lëndë e module ku secila vlerësohet me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Ky program, që i takon ciklit të dytë të studimeve, organizohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në 4 semestra (2 për çdo vit), në gjuhën shqipe dhe vlerësohet gjithsej me 120 kredite. Lëndët janë të ndara sipas kategorive referuar përcaktimeve ligjore. Kurrikula e programit të studimit, referuar planit mësimor të ndarë sipas veprimtarive formuese, përmban 13 lëndë/module, praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse (temën e diplomës).</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1.5 Licenca Ba, MSH, MP 11.11.2011.pdf; EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 11.6 VEPRIMTARIA FORMUESE E PROGRAMIT TE STUDIMIT.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, GVJ konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike si dhe me aftësim për kërkim shkencor në fushën e kontabilitetit dhe financës me profil kontabilitetin. Objektivi është përgatitja e profesionistëve të kontabilitetit, si studiues dhe njohës të mirë të kësaj fushe, të aftë për të analizuar sfidat dhe mundësitë që hasin bizneset e ndryshme në mjedisin global financiar.</p> <p>GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit shprehet në mënyrë të përgjithshme pa përcaktuar në mënyrë të qartë fushat e specializimit të studentëve që ndjekin këtë program studimi, ndërsa në aneksin bashkëlidhur radhiten mundësitë e punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi si ekonomistë, financierë, kontabilistë, auditues, specialistë në sektorin bankar etj.</p> <p>Plani mësimor përfshin lëndë karakterizuese dhe ndërdisiplinore si: “Legjislacioni Tatimor”, “Analiza dhe Kontrolli i Kostos”, “Kontabiliteti Financiar i Avancuar”, “Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit”, “Kontabiliteti Publik”, Kontabiliteti i Drejtimit”, “Analiza Financiare e Avancuar”, “Financa e Korporatës” dhe “Sistemi Bankar dhe Financiar” duke mbuluar thuajse të gjitha aspektet e kryesore të fushës së</p>

	<p>kontabilitetit dhe pjesërisht të fushës së financës. GVJ konstaton se ky program studimi nuk parashikon lëndë me zgjedhje.</p> <p>Gjithashtu, nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve dhe informacionit të marrë në takimet me pedagogët dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se në tërësi lëndët e ofruara në këtë program studimi si edhe përmbajtja e tyre mundësojnë ndërthurjen dhe integrimin e njohurive në mënyrë të tillë që, nga ana teknike, e aftësojnë studentin të përgatitet për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e programit të studimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që rregullorja e programit të studimit të specifikojë qartë fushën akademike të përgjithshme dhe specifike të programit të studimit. Gjithashtu edhe Rregullorja e Departamentit duhet të përditësohet me përcaktime më të plota në funksion të natyrës specifike të programeve të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës (DESF).</i></p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 11.6 VEPRIMTARIA FORMUESE E PROGRAMIT TE STUDIMIT.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” parashikon kryerjen e praktikës profesionale, të klasifikuar në kategorinë D me 12 kredite (ETCS) dhe mbrojtjen e temës së diplomës si detyrim përmbyllës, të klasifikuar në kategorinë E me 18 kredite.</p> <p>Klasifikimi sipas veprimtarisë formuese dhe përcaktimi i krediteve është në përputhje me VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr 879. Një kredit është përlllogaritur 25 orë pune e studentit.</p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>

80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” i UniBa, është hapur me Vendimin e MASH, Nr. 549, datë 11.11.2011. Ky program studimi organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse. UniBa nuk është IAL me status të veçantë.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programe studimi të ciklit të dytë, “Master” në fushën e “Kontabilitetit” ofrohen edhe nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda vendit. UniBa ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione të IAL në Shqipëri dhe një pjesë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit është apo ka qenë pjesë e personelit akademik të këtyre institucioneve, si dhe ka kontribuar me opinione në hartimin e planit mësimor (kurrikulës) dhe syllabuseve (programeve lëndore). GVJ vlerëson se plani mësimor i programit të studimit është hartuar bazuar edhe në kurrikulat që ofrohen nga institucione të tjera të arsimit të lartë në vend dhe se në tërësinë e tij ky program studimi është i ngjashëm në masën 70% - duke konsideruar të gjithë lëndët e planit mësimor (lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, praktikën dhe detyrimet përmblylëse) me programet e tjera të të njëjtit cikël studimi dhe që kanë të njëjtën emërtesë. <i>Megjithatë GVJ konstaton se ky program studimi nuk parashikon lëndë me zgjedhje, në dallim nga shumica e programeve të studimit “Master i Shkencave”.</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Program i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” është program i ciklit të dytë të studimeve, në fushën e kontabilitetit dhe financës (me profil kontabilitet) dhe i përket nivelit të shtatë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve sipas Ligjit nr. 10247, datë 04.03.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk aplikohet, sepse programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” nuk është i përbashkët me institucione të tjera të arsimit të lartë.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Programi i studimit është organizuar në tërësi në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit. - Objektivat, fusha specifike e studimit dhe e specializimit të programit të studimit duhet të jetë e shprehur në rregulloren e programit të studimit.

	<p>- Rregullorja e DESF duhet të shprehet me përcaktime më të plota në funksion të natyrës specifike të programeve të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon departamenti.</p> <p>- Program i studimit është 70% i ngjashëm me programet e tjera të studimit me të njëjtën emërtësë, por nuk parashikon lëndë me zgjedhje.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet kryesisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacioni shoqërues, si dhe informacionet e marra në takimet gjatë vizitës, GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin detyrimet për organizimin dhe strukturën akademike në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” është Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD) të UniBa. Ky fakultet së bashku me Fakultetin e Shkencave të Aplikuara & Industrive Kreative dhe Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit & Sportit janë tri njësitë kryesore të UniBa, rezultat i riorganizimit të ish – Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti” të miratuar me UMASH nr.213 të vitit 2020.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse e këtij programi studimi është Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës (DESF), që së bashku me Departamentin e Qeverisjes, Shkencave Politike & Komunikimi dhe Departamentin e Drejtësisë përbëjnë njësitë bazë të zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore dhe shkencore në FEQD.</p> <p>UniBa ka marrë akreditimin e parë institucional nga ASCAL me Vendimin Nr. 9, datë 07.04.2017 nga Bordi i Akreditimit si Shkolla e Lartë Universitare, Jopublike, "Universiteti Marin Barleti" dhe është riakredituar me Vendimin Nr. 60 të vitit 2021 nën emërtimin “Universiteti Barleti”.</p> <p>Ky program studimi, si pjesë e programit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me disa profile ka marrë fillimisht vlerësimin e akreditimit me kusht nga Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë (KA), me vendimin Nr. 67, datë 27.07.2015. Më pas, me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 604, datë 22.12.2016 programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me disa profile është akredituar sipas të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që buronin nga kuadri ligjor në fuqi, pasi me vendimin Nr.207, datë 18.11.2016 të KA</p>

janë konsideruar të plotësuar kushtet për akreditim të vendosura në vendimin e mëparshëm të KA.

Bazuar në evidencën shitesë të vënë në dispozicion me kërkesën e GVJ gjatë vizitës në institucion, personeli akademik i angazhuar pranë Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës në funksion të këtij programi studimi gjatë tre viteve të fundit akademike paraqitet si vijon:

Departamenti ESF	PAE	PAK	Totali	Raporti PAE/PAK
2019-2020	7	2	9	78%
2020-2021	6	2	8	75%
2021-2022	7	5	12	58%

Nga shqyrtimi i informacioneve të mësipërme, GVJ konstaton se:

- Personeli efektiv i angazhuar pranë Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës plotëson kriteret lidhur me numrin minimal që kërkohet nga Ligji nr. 80 /2015, por raporti i personelit efektiv ndaj totalit të personelit akademik ka ardhur në rënie.
- Tre pedagogë të angazhuar në këtë program studimi gjatë vitit akademik 2021-2022 mbajnë kualifikimin Master.
- Ka mospërputhje në raportimin e personelit akademik të angazhuar pranë këtij programi studimi dhe për Departamentin për vitin akademik 2021-2022 mes informacionit të dokumentacionit shitesë dhe informacionit të depozituar në sistemin e Ascal (në numër dhe në emër).

GVJ rekomandon që institucioni duhet të tregojë një kujdes të shtuar lidhur me angazhimin e personelit akademik në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi dhe duhet të plotësojë dokumentacionin përkatës në mënyrë të plotë dhe të qartë.

[Referenca: Raporti i Vlersimit të Brendshëm.pdf; Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; eVIDENCA 1.4 c vNEDIMI I ba NR 9 DT 07.04.2017.pdf; evidenca 1.4 e Vendimi i bordit të akreditimit institucional nr 60 dt 16.12.2021.pdf; Evidenca 1.6 UMAS - MSHKF.pdf; Evidenca 1.9 vENDIM 207 DT 11.12.2016.pdf; Doc. Shitesë Tabela e Personelit Akademik të DESF (3 vite).pdf; Tabela personeli akademik në PS MSH-K.pdf; vizita në institucion]

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Gjithashtu GVJ konstatoi se Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD) dhe Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës nuk ka angazhuar personel ndihmës akademik apo administrative të dedikuar. Personeli administrativ i angazhuar në UniBa është në nivel institucioni dhe jo njësie kryesore apo njësie bazë.

Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se praktika profesionale, e parashikuar në këtë program studimi për t'u zhvilluar në semestrin e katërt, ndiqet nga një pedagog i caktuar nga departamenti në përputhje

	<p>me procedurat e parashikuara në paketën e praktikës si dhe nga mbikqyrësi në institucionin/subjektin ku zhvillohet praktika.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 11.3 SYLLABUS UNIBA PAKETA E PRKTIKES MASTER PRILL 2021.pdf; vizita në institucion]</p>										
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ konstaton se me vendimin nr. 29 të datës 14.10.2022 Rektorja e UniBa ka emëruar Koordinatorin e Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës (DESF) që mbulon edhe programin e studimit “Master në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”. Në Rregulloren e UniBa dhe në Rregulloren e Departamentit parashikohen edhe detyrat specifike që realizon ky rol duke filluar që nga organizimi i mbledhjeve të departamentit, komunikimi dhe koordinimi me pedagogët sipas programeve të studimit, mbikëqyrja e zhvillimit të programit të studimit, komunikimi i vijueshëm me studentët për të gjitha problematikat e lidhura me realizimin e programit të studimit, bashkëpunimi me sekretarinë mësimore dhe njësitë e tjera institucionale e deri tek përditësimi i informacioneve në faqen zyrtare web të UniBa.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; EVIDENCA 1.3 RREGULLORE DESF.pdf; Evidenca 1.7 Vendimi nr 29 dta 14.10.22 Korrdinatori i departamentit.pdf]</p>										
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë dhe DESF i përmbushin kryesisht standardet ligjore lidhur me organizimin dhe strukturën e këtyre njësive. - Nuk ka personel ndihmës akademik apo administrativ në nivel njësie kryesore/bazë, por vetëm në nivel institucioni. - Koordinatorja është përgjegjëse për të gjitha programet e studimit që mbulon DESF. 										
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet ndryshe</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet ndryshe			X		
	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet ndryshe							
		X									

<p>Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD) dhe Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës (DESF), kanë hartuar rregulloret përkatëse dhe kanë përgatitur të gjithë dokumentacionin për zhvillimin e programit të studimit duke përfshirë planin mësimor, programet e lëndëve, informacionin mbi stafin akademik të angazhuar në programin e studimit etj.</p> <p>Megjithatë, GVJ rekomandon që Rregullorja e DESF dhe Rregullorja e Programit të Studimit duhet të përditësohen me përcaktime më të plota në</p>

	<p><i>funkcion të natyrës specifike të programeve të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon departamenti.</i></p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor i programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” përmban informacion në lidhje me ngarkesën mësimore sipas semestrave, orët në auditor dhe jashtë auditorit, të ndara në orë leksioni dhe orë seminari.</p> <p>Ky program, që i takon ciklit të dytë të studimeve, organizohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në 4 semestra (2 për çdo vit), në gjuhën shqipe dhe vlerësohet gjithsej me 120 kredite. Plani mësimor i këtij programi studimi parashikon realizimin gjatë 2 viteve akademike të 3'000 orëve mësimore të shpërndara si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 450 orë mësimore në auditor leksione; ▪ 235 orë mësimore në auditor seminare, ushtrime & detyra kursi; ▪ 333 orë mësimore praktikë & diploma; ▪ 1'982 orë punë e individuale jashtë auditorit. <p>Në planin mësimor të ndarë sipas veprimtarive formuese është përcaktuar klasifikimi i lëndëve/moduleve dhe vlerësimi i tyre me kredite sipas tipologjisë së përcaktuar në VKM nr.41:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kategoria A – një lëndë bazë me 6 ECTS zë 5% të krediteve (brenda kufijve ligjorë 5% - 10% të krediteve); ▪ Kategoria B – nëntë lëndë karakterizuese me 66 ECTS zënë 55% të krediteve (brenda kufijve 50% - 60% të krediteve); ▪ Kategoria C – tri lëndë ndërdisiplinore me 18 ECTS zënë 15% të krediteve (brenda kufijve 12% - 20% të krediteve); ▪ Kategoria D – një lëndë plotësuese (praktika profesionale) me 12 ECTS zë 10% të krediteve (brenda kufirit prek 10% të krediteve); ▪ Kategoria E – tema e diplomës si detyrim përmbysllës me 18 ECTS zë 15% të krediteve (brenda kufijve 10% -15% të krediteve). <p>Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese janë përlllogaritur dukë mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është përlllogaritur 25 orë pune e studentit, ku përfshihen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekte/detyra kursi), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>GVJ vlerëson se përfshirja e lëndëve në secilën kategori është përgjithësisht në përputhje me fokusin e çdo lënde, si dhe pesha e lëndëve për secilën kategori është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit dhe në programet e lëndëve (syllabuset), përfshihet edhe informacioni lidhur me rregullat e frekuentimit/ndjekjes së programit të studimit (i detyrueshëm në masën</p>

	<p>50% të orëve të leksioneve dhe 75% të orëve të seminareve/ praktikave), mënyrën e vlerësimit të njohurive nga studentët, metodat e mësimdhënies etj.</p> <p>GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi ishte pothuajse i harmonizuar (me përjashtim të një lënde) sipas parashikimeve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 50% nga vlerësimi i aktiviteteve gjatë semestrit akademik ku përfshihen frekuentimi, aktivizimi në seminare dhe kontrollet e tjera të vijueshme si teste, raste studimore, detyra dhe projekte kursi; ▪ 50% nga vlerësimi në provimin në fund të semestrit. <p>[Referenca: EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në Statutin dhe në rregulloret e UniBa, parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. Sipas parashikimeve në këto rregullore, pranimi në këtë program studimi është i mundur për studentët që zotërojnë një diplomë të Ciklit të Parë, të përfunduar në një IAL brenda ose jashtë vendit të njohur nga MAS, dëshmojnë njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të BE në nivelin e përcaktuar nga kuadri ligjor në fuqi dhe pranojnë të paguajnë tarifën e përcaktuar të studimeve.</p> <p>Rregullorja e UniBa dhe Rregullorja e Brendshme për Transferimin japin informacion të plotë lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe periudhave të mëparshme të studimit. Institucioni ka haruar edhe një manual të posaçëm lidhur me procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit pranë UniBa.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 18, MANUAL PER REKRUTIMIN, APLIKIMIN, REGJISTRIMIN DHE TRANSFERIMIN E STUDENTEVE NE UNIVERSITETIN BARLETI.pdf; Evidenca 35. Rregullore e Brendshme per Transferimet.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit dhe programet e çdo lënde (syllabuset) janë të unifikuar dhe të hartuar sipas formatit të kërkuar nga VKM nr. 41, ndryshuar me VKM nr. 879. Ato përmbajnë informacionin e domosdoshëm për zhvillimin e një lënde: ngarkesën mësimore, semestrin kur zhvillohet, konceptet themelore të lëndës, temat që zhvillohen çdo javë, rregullat e frekuentimit dhe vlerësimit të dijeve në lëndë, literaturën bazë dhe atë ndihmëse etj.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf]</p>

<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Në takimin me personelin akademik, gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se në fillim të çdo viti akademik, në mbledhjen e Departamentit të i Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës diskutohet mbi syllabuset e programit të studimit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e tyre, si një proces i vazhdueshëm dhe që ndikon në rritjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>GVJ konstatoi se ky program studimi ka pësuar ndryshime kundrejt akreditimit të mëparshëm si rezultat i përshtatjes me ndryshimet në kuadrin rregullator (VKM 41 dhe VKM 879) por jo vetëm. Konkretisht, nga krahasimi i planit mësimor të zhvilluar në vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 me planin mësimor të përshtatur sipas strukturës së vitit akademik 2015-2016, GVJ konstatoi disa ndryshime të rëndësishme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Është shtuar lënda “Kontabilitet Publik” me 7 kredite, në semestrin e tretë; ▪ Janë shtuar kreditet e katër lëndëve të tjera (1-2 kredite) dhe janë pakësuar kreditet e detyrimeve përmbyllëse (me 12 kredite); ▪ Janë pakësuar orët mësimore të parashikuara për t’u zhvilluar në auditor si seminare, ushtrime dhe detyra kursi. Konkretisht, nga 300 orë të parashikuara në planin mësimor të vitit akademik 2015-2016 numri i orëve në auditor për seminare etj ka zbritur në 235 orë. <p>Në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, nuk ndeshet ndonjë praktikë lidhur me këto ndryshime (vendimarrja dhe arsyet e ndryshimeve nga njësia bazë) me përjashtim të dokumentit EVIDENCA 2 që prezanton strukturën aktuale të planit mësimor të këtij programi studimi.</p> <p><i>GVJ vlerëson se ndryshime të tilla duhet të dokumentohen në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe se praktika rregullatore e UniBa duhet të përditësohet për këtë aspekt.</i></p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UniBa disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. - Plani mësimor dhe syllabuset e programit të studimit janë strukturuar dhe organizuar kryesisht sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. - Kuadri rregullator i UniBa parashikon kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. - Ky program studimi ka pësuar ndryshime kundrejt akreditimit të mëparshëm si rezultat i përshtatjes me ndryshimet në kuadrin rregullator dhe në UniBa, por praktika e dokumentimit të ndryshimeve nuk është e plotë.
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>Përmbushet kryesisht</p> <p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, përfshirja e lëndëve në secilën kategori, praktika profesionale, si dhe përmbajtja e programit të studimit me temë diplome u mundësojnë studentëve thellimin e njohurive dhe aftësive të tyre në fushën e kontabilitetit, duke i përgatitur për punësimin si pranë sektorit publik, ashtu edhe atij privat. Por GVJ konstaton se krahasuar me programe studimit të ngjashme në nivel kombëtar, ky program studimi nuk parashikon lëndë me zgjedhje dhe se disa lëndë/module ruajnë të njëjtin emërtim si në programin bachelor.</p> <p><i>Prandaj GVJ rekomandon që emërtimet e disa lëndëve/moduleve në këtë program studimi duhet të përditësohen në përputhje me ciklin e studimeve master dhe të shihet mundësia e përfshirjes së lëndëve me zgjedhje.</i></p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” i takon ciklit të dytë të studimeve, organizohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në 4 semestra (2 për çdo vit), në gjuhën shqipe dhe vlerësohet gjithsej me 120 kredite. Plani mësimor i këtij programi studimi parashikon realizimin gjatë 2 viteve akademike të 3000 orëve mësimore të shpërndara si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 450 orë mësimore në auditor leksione; ▪ 235 orë mësimore në auditor seminare, ushtrime & detyra kursi; ▪ 333 orë mësimore praktikë & diploma; ▪ 1’982 orë punë individuale jashtë auditorit. <p>Vlerësimi në kredite i lëndëve në secilën kategori është në përputhje me fokusin e çdo lënde, si dhe pesha e lëndëve për secilën kategori është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Shpërndarja sipas semestrave dhe vlerësimi në kredite i lëndëve mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional në fushën e kontabilitetit.</p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është</p>	

<p>në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor dhe programet e lëndëve dhe nga takimet me pedagogë dhe studentë, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit dhe shpërndarja e orëve mësimore dhe krediteve në dy vite akademike është e balancuar.</p> <p>GVJ vlerëson struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është kryesisht në përputhje me profilin e programit master në fushën e kontabilitetit dhe financës dhe e ngjashme me programe të të njëjtit profil në nivel kombëtar e më gjerë. Siç u përmend edhe më sipër, GVJ konstaton se ky program studimi nuk parashikon lëndë me zgjedhje krahasuar me programe studimi të ngjashme në nivel kombëtar dhe numri i lëndëve/moduleve nga fusha e financës është relativisht i kufizuar.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Duke iu referuar vetëm orëve mësimore në auditor, plani mësimor i këtij programi studimi parashikon realizimin në dy vite akademike të sa vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Teori (leksione) 450 orë mësimore në auditor; ▪ Praktikë (seminare/ ushtrime & detyra kursi /praktikë & diplomë) 568 orë në auditor. <p>Raporti Teori / Praktikë, për orët mësimore në auditor, rezulton 0.8.</p> <p>Njohuritë e ofruara në këtë program studimi janë kryesisht të mjaftueshme për të formuar një specialist të fushës së kontabilitetit përsa i takon njohurive të parashikuara në nivelin e studimeve Master.</p> <p><i>GVJ rekomandon përfshirjen, qoftë edhe me zgjedhje të një lënde/moduli nga fusha e sistemeve të informacionit si dhe shtimin e lëndëve/moduleve nga fusha e financës.</i></p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se programet e lëndëve rishikohen çdo vit akademik dhe literatura e detyrueshme dhe ndihmëse përditësohet me literaturën bashkëkohore në shqip dhe gjuhë të huaj</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, si dhe syllabuset përkatës u ofrojnë studentëve mundësinë e përfitimit të dijeve, aftësive dhe kompetencave që nevojiten për një program studimi të nivelit Master.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ vlerëson se përmbajtja e këtij programi studimi u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë (doktoraturë) apo punësimin dhe ndjekjen e kualifikimeve profesionale në fushën e kontabilitetit.</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; vizita në institucion]</i></p>

Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë, janë kryesisht në përputhje me profilin e programit master në fushën e kontabilitetit dhe financës, si dhe të ngjashme me programe të të njëjtit profil në nivel kombëtar e më gjerë. - Emërtimet e disa lëndëve/moduleve në këtë program studimi duhet të përditësohen në përputhje me ciklin e studimeve master dhe të shihet mundësia e përfshirjes së lëndëve me zgjedhje. - Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara si dhe vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë, punësimin apo ndjekjen e kualifikimeve profesionale në fushën e kontabilitetit. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UniBa ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme, nga të cilat mundohet të përfitojë edhe në kuadër të konsultimeve për rritjen e cilësisë së programeve të studimit që ofron. Që prej vitit 2019, pranë Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës (DESF) është krijuar Bordi i Karrierës me përfaqësues nga tregu i punës me objektiv bashkëpunimin me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave të programeve të studimit të ofruara apo të reja nga departamenti. Gjatë vitit 2022, DESF ka realizuar edhe një studim tregu për programet e studimit që mbulon si departament, që shërben edhe si bazë e strategjisë së zhvillimit të departamentit. Gjithashtu, vitin e fundit është krijuar Barleti Business Partner me përfaqësues nga biznese të ndryshme me të cilët departamenti realizon takime të hapura me studentët dhe aktivitete të tjera të përbashkëta.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 5.0 strategjia MSHFK.pdf; EVIDENCA 28 VENDIMI PER KRIJIMIN E BORDIT TE KARREIRES, DESF.pdf; Doc. shitesë 6. Barleti Business Partners - Takime.pdf; 6.2. Partneritete UniBA FK.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të</p>	<p>GVJ konstaton se UniBa ka siguruar përfshirjen e opinionit të studentëve përmes pjesëmarrjes së tyre në Senatin Akademik të UniBa, në Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta, në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë si edhe pranë Grupit të Vlerësimit</p>

studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	të Brendshëm të këtij programi studimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të institucionit. Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se departamenti organizon mbledhje të hapura ku ftohen studentët të japin mendimin e tyre lidhur me përmirësimin e programit të studimit. Ndërkohë përmes zyrës së Alumni dhe Karrierës, departamenti mban kontakte edhe me të diplomuarit dhe i fton në aktivitetet e organizuara në UniBa. <i>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 37. Politika te mbeshtetjes, perkrahjes per studentet dhe strukturat organizative te tyre.pdf; EVIDENCA 20.9 RAPORT VJETOR ALUMNI.pdf; vizita në institucion]</i>								
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu komunikua se gjatë aktiviteteve të ndryshme si tryeza të rumbullakta, workshop-e e takime me sipërmarrës, me profesionistë të fushës dhe me drejtues të institucioneve publike, Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës angazhohet edhe për përmirësimin dhe përditësimin e programeve të studimit në përputhje me zhvillimet e reja në fushën e studimit dhe kërkesat e tregut të punës. <i>[Referenca: Vizita në institucion]</i>								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - UniBa ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme, nga të cilat mundohet të përfitojë edhe në kuadër të konsultimeve për rritjen e cilësisë së programeve të studimit që ofron. - Gjatë vitit 2022, DESF ka realizuar një studim tregu për programet e studimit që mbulon si departament. - DESF angazhohet për të reflektuar mendimet e studentëve dhe propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme nëpërmjet konsultimit me aktorë të biznesit dhe institucione të ndryshme.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet jo</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet jo				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet jo						
			X						

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se Rregullorja dhe Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” përmbajnë objektivat e tij të cilat janë në përputhje me objektivat kryesorë të UniBa të paraqitura në Statut dhe në Strategjinë e Zhvillimit Institucional. <i>Por GVJ rekomandon që rregullorja e programit të studimit duhet të shprehë më qartë fushat akademike dhe kërkimore në funksion të prioriteteve specifike të këtij programi studimi.</i> <i>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te institucional 2020-2030.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; Evidenca 5.0 strategjia MSHFK.pdf]</i>

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës (DESF) mbështet personelin akademik në procesin e mësimdhënies dhe në aktivitetin e tij kërkimor dhe shkencor duke respektuar lirinë e tij akademike.</p> <p>Liria akademike përcaktohet si një parim mbi të cilin mbështetet aktiviteti i personelit akademik pothuaj në të gjitha aktet dhe rregulloret e institucionit si Statuti (neni 3), rregullore e UniBa, rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes & Drejtësisë, rregullore e programit të studimit etj.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 1 Rregullore e FEQD.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të institucional 2020-2030.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; Evidenca 5.0 strategjia MSHFK.pdf]</i></p>						
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe të marrë nga vizita në institucion, GVJ vlerëson se ky program studimi mundëson dhe nxit angazhimin e studentëve në projekte dhe aktivitete të tjera shkencore kryesisht përmes përfshirjes së tyre në klubet studentore, në mobilitete të projektit Erasmus+ dhe në aktivitetet e parashikuara të programit mësimor (përgatitja e temës së diplomës, detyrat e kursit, kryerjes së praktikës profesionale).</p>						
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Megjithatë GVJ konstaton se aktualisht angazhimi i studentëve të këtij programi studimi në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore është në nivele modeste.</p> <p>Gjithashtu, në takimin me personelin akademik të këtij programi studimi, GVJ mori konfirmin e mbështetjes financiare që UniBa u jepte përmes pjesëmarrjes pa pagesë në konferencat shkencore të organizuara nga institucioni, botimit të teksteve mësimore për studentët nga Shtëpia Botuese Dudaj (njësi ekonomike e lidhur me UniBa), zvogëlimi i ngarkesës në auditor për pedagogët në proces kualifikimi grade/titulli shkencor si dhe angazhimit në projekte ndërdisiplinore pranë qendrave kërkimore të UniBa.</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit të Brendshëm.pdf; Evidenca 6 të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional.pdf; EVIDENCA 21 RELACION PER KERKIMIN SHKENCOR.pdf;]</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e programit të studimit përcakton objektivat e programit të studimit në përputhje me objektivat kryesorë të institucionit. - UniBa respekton lirinë akademike të personelit akademik. - Programi i studimit u mundëson studentëve angazhimin në projekte dhe aktivitete kërkimore të institucionit. - UniBa angazhohet për mbështetjen financiare të kërkimit shkencor. 						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="592 1731 810 1809">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="810 1731 991 1809">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="991 1731 1214 1809">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="592 1809 810 1852"></td> <td data-bbox="810 1809 991 1852"></td> <td data-bbox="991 1809 1214 1852" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Në Strategjinë e Zhvillimit Institucional, Kërkimi i aplikuar dhe Inovacioni përcaktohet si një nga shtyllat e zhvillimit dhe ku mbështetet misioni i UniBa. Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, publike dhe private, me sipërmarrje biznesi dhe organizata të ndryshme në mënyrë që të zhvillojë edhe punën kërkimore të personelit akademik dhe studentëve. Gjithashtu, pranë UniBa funksionojnë disa institute dhe qendra (si BIRD, AIPA, BEI, ADRIAPOL etj), të cilat shërbejnë si inkubatorë të punës shkencore dhe angazhimeve profesionale të pedagogëve dhe përmes të cilave personeli akademik i çdo departamenti mund të angazhohet në projekte të ndryshme për arritjen e objektivave lidhur me kërkimin shkencor.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te institucional 2020-2030.pdf; Evidenca 8.2 Projekte te uniba (kerkimi i aplikuar) me staf , tetor 2022.pdf; Evidenca 8.3 Kerkimi i aplikaur, projekte ne UNIBA 2015 - 2021 me staf.pdf; EVIDENCA 8.7 POLITIKA TE ZHVILLIMIT TE STAFIT.pdf; Evidenca 9.4 Raport mjeter i kerkimit 2019 - 2020.pdf; EVIDENCA 21 RELACION PER KERKIMIN SHKENCOR.pdf; EVIDENCA 43.a TE DHENA TE AKTIVITETEVE PER KUALIFIKIMIN DHE KERKIMIN SHKENCOR TE STAFIT AKADEMIK.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se UniBA mbështet dhe nxit personelin akademik dhe studentët për t'u anagazhuar në projekte dhe analiza me karakter kërkimor shkencor. Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB, rezultoi se personeli akademik i DESF ka marrë pjesë në projekte Erasmus +, në projekte të Instituteve dhe Qendrave Kërkimore të UniBa të realizuara në bashkëpunim me institucione shtetërore dhe organizata të tjera jo-fitimprurëse. Megjithatë GVJ konstaton që angazhimi në këto projekte nuk lidhet drejtpërdrejt me fushën e programit të studimit "Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë" me profil "Kontabilitet". Prandaj GVJ rekomandon që DESF duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje angazhimit në projekte që lidhen drejtpërdrejt me fushën e kontabilitetit dhe financës.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 8.2 Projekte te uniba (kerkimi i aplikuar) me staf , tetor 2022.pdf; Evidenca 8.3 Kerkimi i aplikaur, projekte ne UNIBA 2015 - 2021 me staf.pdf; Evidenca 9.4 Raport mjeter i kerkimit 2019 - 2020.pdf; EVIDENCA 21 RELACION PER KERKIMIN SHKENCOR.pdf; EVIDENCA 43.a TE DHENA TE AKTIVITETEVE PER KUALIFIKIMIN DHE KERKIMIN SHKENCOR TE STAFIT AKADEMIK.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë</p>	<p>Referuar dokumentacionit vënë në dispozicion, GVJ konstaton se aktivitetet kryesisht i referohen takimeve dhe leksioneve të hapuara me ekspertë të fushës dhe pothuajse mungon organizimi i aktiviteteve shkencore që lidhen drejtpërdrejt me fushën e programit të studimit.</p>

personelin dhe studentët për arrijten e objektivave.	[Referenca: Evidenca 8.2 Projekte te uniba (kerkimi i aplikuar) me staf , tetor 2022.pdf; Evidenca 8.3 Kerkimi i aplikaur, projekte ne UNIBA 2015 - 2021 me staf.pdf; Evidenca 9.4 Raport mjeter i kerkimit 2019 - 2020.pdf; EVIDENCA 21 RELACION PER KERKIMIN SHKENCOR.pdf; EVIDENCA 43.a TE DHENA TE AKTIVITETEVE PER KUALIFIKIMIN DHE KERKIMIN SHKENCOR TE STAFIT AKADEMIK.pdf]			
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” synon të formojë studiues dhe njohës të mirë të fushës së kontabilitetit, si dhe profesionistë të aftë për të analizuar sfidat dhe mundësitë që hasin bizneset e ndryshme në mjedisin financiar global. Siç u përmend edhe më sipër (Fusha 2.4) GVJ rekomandon përfshirjen, qoftë edhe me zgjedhje, të një lënde nga fusha e sistemeve të informacionit si dhe saktësimin e emërimit të lëndëve në përputhje me ciklin e studimeve master, për të rritur konkurrueshmërinë në tregun e punës, të të diplomuarve të këtij programi studimi. [Referenca: EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf;			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe të marrë nga vizita në institucion, GVJ konstaton angazhimin e institucionit për të marrë në konsideratë sugjerimet dhe rekomandimet e nxjerra nga organizatat profesionale (si IEKA) dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin e aktiviteteve mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore. GVJ vlerëson se megjithëse programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” nuk është program studimi i dedikuar për profesionet e rregulluara u mundëson studentëve ndjekjen e kualifikimeve profesionale të parashikuara nga kuadri ligjor vendas për marrjen e licencës së profesioneve të lira në fushën e kontabilitetit. [Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; Vizita në institucion]			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).	GVJ konstaton se: - Institucioni angazhohet në mbështetjen e kërimit shkencor nëpërmjet instituteve dhe qendrave kërkimore të UniBa dhe lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL të tjera, institucione publike, sipërmarrje private etj. - Aktivitetet shkencore kryesisht i referohen takimeve dhe leksioneve të hapuara me ekspertë të fushës dhe pothuajse mungon organizimi i aktiviteteve shkencore që lidhen drejtpërdrejt me fushën e këtij programi studimi.			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues rezultoi se format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në programin e studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” pranë Universitetit Barleti (UniBa) janë leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit dhe praktika profesionale. Gjithashtu, konstatohet se institucioni nxit edhe zhvillimin e leksioneve të hapura me specialistë të fushës.</p> <p>Plani mësimor i këtij programi studimi parashikon realizimin gjatë 2 viteve akademike të 3'000 orëve mësimore të shpërndara si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 450 orë mësimore në auditor leksione; ▪ 235 orë mësimore në auditor seminare, ushtrime & detyra kursi; ▪ 333 orë mësimore praktikë & diploma; ▪ 1'982 orë punë e individuale jashtë auditorit. <p>Në syllabusin e çdo lënde është i përfshirë informacioni në lidhje me numrin e orëve të leksioneve, seminareve dhe projekteve/detyrave. Në syllabus është e përcaktuar edhe mënyra e vlerësimit të studentëve me pikë (në %) dhe notë (vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi final), si dhe detyrimet për frekuentim të lëndës në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të UniBa.</p> <p>Nga krahasimi i planit mësimor të zhvilluar në vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 me planin mësimor të përshtatur sipas strukturës së vitit akademik 2015-2016, GVJ konstatoi disa ndryshime të rëndësishme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Është shtuar lënda “Kontabilitet Publik” me 7 kredite, në semestrin e tretë; ▪ Janë shtuar kreditet e katër lëndëve të tjera (1-2 kredite) dhe janë pakësuar kreditet e detyrimeve përmbyllëse (me 12 kredite);

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Janë pakësuar orët mësimore të parashikuara për t'u zhvilluar në auditor si seminare, ushtrime dhe detyra kursi. Konkretisht nga 300 orë të parashikuara në planin mësimor të vitit akademik 2015-2016 numri i orëve në auditor për seminare etj ka zbritur në 235 orë. <p>Në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, nuk ndeshet ndonjë praktikë lidhur me këto ndryshime (vendimarrja dhe arsyet e ndryshimeve nga njësia bazë) me përjashtim të dokumentit EVIDENCA 2 që prezanton strukturën aktuale të planit mësimor të këtij programi studimi.</p> <p><i>GVJ vlerëson se ndryshime të tilla duhet të dokumentohen në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe se praktika rregullatore e UniBa duhet të përditësohet për këtë aspekt.</i></p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1 Rregullore e FEQD.pdf; EVIDENCA 1.3 RREGULLORE DESF.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11.3 SYLLABUS.pdf; Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ mori konfirmimin se personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta dhe pa dallime diskriminuese, për të gjithë studentët në arritjen e objektivave të tyre akademike.</p> <p>Në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies, duke integruar teknologjinë në mësimdhënie dhe duke nxitur përfshirjen aktive të studentëve përmes projekteve dhe detyrave të kursit, punës në grup për të nxitur diskutimet dhe bashkëpunimin sipas roleve, si dhe për të përmirësuar programin e studimit në bazë të reagimeve dhe opinionëve të studentëve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 11.3 SYLLABUS.pdf; Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson angazhimin e UniBa në mbështetjen e personelit akademik për plotësimin dhe përmirësimin e kompetencave didaktike përmes organizimit të trajnimeve dhe leksioneve të hapura për personelin akademik në institucion, mbështetjes me fonde të veçanta për pjesëmarrje në trajnime dhe konferenca jashtë institucionit si dhe përmes hartimit të udhëzuesve dhe manualeve në ndihmë të organizimit të mësimit dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 8.7 POLITIKA TE ZHVILLIMIT TE STAFIT.pdf; EVIDENCA 11 UDHEZUAES PER METODAT E MESIMDHENIES.pdf; Aneks 3. Manuali i përdorimit të GSuit.pdf; Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe jetëshkrimeve të personelit akademik, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit "Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë" me profil</p>

<p>koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në gendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>“Kontabilitet” përmbush kryesisht kërkesat ligjore në fuqi për mësimdhënie në ciklin e dytë të studimeve pasi ka kryesisht kualifikimin dhe kompetencat e duhura për shpjegimin e njohurive. Siç u përmend më sipër (Fusha I.2) gjatë vitit akademik 2021-2022, për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej 12 pedagogë nga të cilët 5 i përkasin kategorisë Profesor, 4 i përkasin kategorisë Lektor dhe mbajnë gradën Doktor, ndërsa 3 pedagogët e tjerë të kategorisë As.Lektor mbajnë kualifikimin Master i Shkencave. Gjatë vizitës në institucion, personeli akademik konfirmoi se nxit studentët gjatë orëve të mësimi të përfshihen sa më shumë edhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies, duke ofruar sugjerime në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit kryesisht përmes pyetësorëve të studentëve, por jo vetëm. Rezultatet e analizës së pyetësorëve të studentëve, në fund të çdo semestri, janë pjesë e analizave që realizojnë në mënyrë periodike të gjitha strukturat drejtuese dhe mësimdhënëse të UniBa, me qëllim përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në institucion.</p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 11.3 SYLLABUS.pdf; EVIDENCA 23.2 CV STAFI AKADEMIK.pdf; EVIDENCA 16.3 FORMULAR RAPORTIMI I PUNES SEMESTRALE TE PEDAGOGUT.pdf; EVIDENCA 16.8 RAPORTI MBI REZULTATET E FORMULARIT TE STUDENTIT 21-22 SEM I.pdf; Evidenca 23. 1 Raporti i vleresimit te studenteve 21-22 sem II.pdf; EVIDENCA 22.0 ANALIZA VJETORE E desf 21 – 22.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe kuadrin rregullator të UniBa, GVJ vlerëson se në funksion të procesit mësimor-kërkimor, në nivel universiteti janë organizuar struktura të posaçme e të pavaruara si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (KSSC); dhe ▪ Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC). <p>që promovojnë dhe monitorojnë cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim edhe me njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>Koordinatori i Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës (DESF), pranë Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD) shërben si një urë lidhëse mes këtyre strukturave të pavarura dhe njësisë bazë në kuadër të bashkërendimit të punës për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (KSSC), strukturë e pavaruar e përhershme, përbëhet nga 5 anëtarë të propozuar nga Rektorati (4 anëtarë nga personeli akademik dhe një anëtar nga këshilli studentor) dhe të miratuar nga Senati i UniBa për një mandat 2 (dy) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. KSSC mbështet dhe këshillon organet drejtuese të UniBa, si dhe lehtëson komunikimin mes strukturave të ndryshme të institucionit lidhur me politikatat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.</p>

	<p>Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC) është strukturë e pavarur pranë UniBa në nivel institucioni dhe përbëhet nga Drejtuesi i Njësisë (personel jo-akademik i punësuar me kohë të plotë) dhe 3 kordinatorë (personel akademik të punësuar me kohë të plotë).</p> <p>NJZHKC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, orienton zhvillimin e kurrikulave si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë të hapësirës europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi. Gjithashtu NJZHKC kujdeset për ruajtjen e standardeve të sigurimit të cilësisë, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar efikasitetin e programeve të studimit, si dhe ndjek procesin e akreditimit të të gjitha programeve të studimit pranë UniBa, në bashkëpunim me personelin akademik të fakultetit dhe departamentit përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni mbështet personelin akademik në kualifikimin e vijueshëm me objektiv përmirësimin dhe implementimin e metodave të reja të mësimdhënies përmes aplikimit në mobilitete Erasmus, pjesëmarrjes në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, botimit të artikujve në revista shkencore vendase dhe të huaja, si dhe përfshirjes në projekte të ndryshme pranë qendrave dhe instituteve kërkimore të UniBa.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstatoi se personeli akademik raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë e tyre (mësimdhënëse, kërkimore dhe administrative) përmes formularëve të punës semestrale, por edhe përmes formularëve të vlerësimit (koleg me koleg dhe të performancës). Ky informacion i përpunuar më pas nga strukturat përkatëse në formën e raporteve në nivel institucioni, bëhet pjesë e analizës vjetore të departamentit, ku mes të tjerash diskutohen efektet dhe problematikat e ndeshura gjatë përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 2. RREGULLORJA E UNIVERSITETIT BARLETI.pdf; Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të institucional 2020-2030.pdf; Evidenca 5.1 Strategjia e Sigurimit të cilësisë UNIBA.pdf; EVIDENCA 8.7 POLITIKA TE ZHVILLIMIT TE STAFIT.pdf; Evidenca 10. Rregullore e NjZHKC.pdf; Evidenca 11. Formular vleresimi të mesimdhënies kolege me kolege.pdf; EVIDENCA 16.3 FORMULAR RAPORTIMI I PUNES SEMESTRALE TE PEDAGOGUT.pdf; EVIDENCA 16.8 RAPORTI MBI REZULTATET E FORMULARIT TE STUDENTIT 21-22 SEM I.pdf; Evidenca 31. Rregullore e Komisionit Standarteve dhe Cilesise.pdf; Raporti i Vlersimit të Brendshem.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Format e mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në këtë program studimi janë në përputhje me parashikimet në kuadrin rregullator në fuqi por ndryshimet duhet të dokumentohen në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë.</i>

	<ul style="list-style-type: none"> - Personeli akademik i programit të studimit është i angazhuar në përditësimin dhe përmirësimin e syllabuseve të lëndëve të këtij programi, si dhe teknikave dhe metodave inovative të mësimdhënies. - Personeli akademik i këtij programi studimi përmbush kryesisht kërkesat ligjore në fuqi për mësimdhënie në ciklin e dytë të studimeve. - Pranë UniBa ka struktura të përshtatshme për të garantuar promovimin dhe përmirësimin e vijueshëm të mësimdhënies. 						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e UniBa dhe Rregullorja e programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”, përcaktojnë të gjitha kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të marra nga studentët gjatë ciklit të studimeve. Gjithashtu, mënyrat e kontrollit të dijeve dhe të vlerësimit përcaktohen edhe në syllabusin e çdo lënde dhe u bëhen të njohura studentëve në fillim të procesit mësimor nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Në faqen zyrtare në internet të institucionit gjenden të publikuara Statuti dhe Rregullorja UniBa, kreu 7-të i së cilës i referohet sistemit të kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të studentëve (nenet 83-96).</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; https://umb.edu.al/dossier-uniba.html]</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët, që në fillim të semestrit, njihen me të gjithë elementët e programit mësimor (syllabusit) përfshirë edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve nga pedagogu i lëndës.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; vizita në institucion]</p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Kuadri rregullator parashikon si forma të kontrollit dhe vlerësimit të nivelit të njohurive që studenti ka përvetësuar gjatë aktivitetit mësimor testimin e ndërmjetëm, detyrat dhe projektet e kursit, prezantimet, provimin e lëndës (me shkrim dhe /ose me gojë), praktikën dhe temën e diplomës.</p> <p>Nga shqyrtimi i programeve mësimore (syllabuseve), GVJ krijoi bindjen se vlerësimi i studentëve realizohet në bazë të formave të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

34

	parashikuara në kuadrin rregullator, duke u dhënë mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara. [Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; vizita në institucion]						
Konkluzione	GVJ konstaton se: <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e UniBa dhe Rregullorja e Programit të Studimit parashikojnë kritere dhe mënyra testimi të kombinuara lidhur me vlerësimin e dijeve të marra prej studentëve. - Studentët informohen që në fillim të semestrit, nga pedagogët dhe syllabuset e lëndës lidhur me kriteret dhe mënyrat e testimit të njohurive. - UniBa mundëson përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies në përputhje me objektivat formuese të programit të studimit. 						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi realizohet sipas parashikimeve në kuadrin rregullator të UniBa.</p> <p>Konkretisht vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi ishte pothuajse i harmonizuar (me përjashtim të një lënde) sipas parashikimeve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 50% nga vlerësimi i aktiviteteve gjatë semestrit akademik ku përfshihen frekuentimi, aktivizimi në seminare dhe kontrollet e tjera të vijueshme si teste, raste studimore, detyra dhe projekte kursi; ▪ 50% nga vlerësimi në provimin në fund të semestrit. <p>[Referenca: EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf]</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	GVJ nuk konstatoi përdorimin e ndonjë sistemi elektronik testimi në funksion të këtij programi studimi përveç përdorimit të platformës “Google Classroom”, kryesisht si rezultat i masave të marra në përgjigje të situatës të krijuar nga pandemia Covid-19. Aktualisht numri i ulët i studentëve nuk justifikon kostot e përdorimit të sistemeve elektronike të vlerësimit në këtë program studimi.

	<i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se provimet përfundimtare zhvillohen me shkrim dhe me procedurë sekretimi, në të cilën angazhohet edhe sekretaria mësimore e UniBa.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Rregullorja e UniBa (nenet 87-88) përcakton se Përgjegjësi i Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës miraton tezën e provimit të përgatitur nga pedagogu përgjegjës për lëndën në përputhje me syllabusin e miratuar. Gjithashtu, në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ mori konfirmimin se në UniBA, bëhet një korrigjim i kujdesshëm i provimeve përfundimtare, si edhe i provimeve të ndërmjetme, i detyrave dhe projekteve të kursit, duke u dhënë studentëve këshilla në funksion të përmirësimit të punës së tyre në të ardhmen. <i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se njësia përgjegjëse dhe personeli akademik monitorojnë me rigorozitet dhe përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën. Në Rregulloren e UniBa dhe në Rregulloren e programit të studimit janë parashikuar edhe masat disiplinore në rastet e konstatimit të sjelljeve të dënueshme si kopjimi në provime, plagjiatura në punime shkencore, shkeljet e rregullores etj (neni 32). Kërkesat e Kodit të Etikës janë përfshirë edhe në programet mësimore (syllabuset). <i>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ mori konfirmimin se në UniBa, bëhet një korrigjim i kujdesshëm i provimeve përfundimtare. Rregullorja e UniBa (neni 91) dhe Rregullorja e programit të studimit (neni 21) parashikojnë një afat komunikimi të rezultateve dhe të dorëzimit të procesverbaleve të provimit nga 7 deri në 15 ditë nga data e zhvillimit të provimit. GVJ vlerëson se në UniBa përdoren instrumenta efektive për të garantuar rezultate të bazuara mbi meritat e punës së studentit. <i>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut,	GVJ konstaton se Rregullorja e UniBa, në kreun 7-të (nenet 89-90), parashikon të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me zhvillimin e provimit dhe vlerësimin në provim, kundrejt një kërkesë me shkrim që i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit. Ankesa për


<p>rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>procesin duhet të paraqitet brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit, ndërsa ankesa për vlerësimin duhet të paraqitet brenda 48 orëve nga komunikimi i rezultateteve të provimit. Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me komisionin e provimeve bëjnë verifikimet dhe rishikimin sipas situatës.</p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në raste të problematikave të veçanta Përgjegjësi i Departamentit vë në dijeni Dekanin e FEQD i cili brenda 48 orëve nga njoftimi vijon me ngritjen e një komisioni të posaçëm <i>ad-hoc</i> për të bërë verifikimet e nevojshme: lidhur me ankesën e studentit.</p> <p><i>GVJ konstatoi qe kuadri rregullator aktual i UniBa nuk parashikon ruajtjen e praktikës së ankimimit, përfshirë komunikimet mes palëve dhe dokumentacionin e shqyrtuar, në përfundim të procesit. Pavarësisht mungesës së problematikave serioze lidhur me ankimimet e studentëve, GVJ rekomandon përditësimin e kuadrit rregullator të UniBa edhe për këtë aspekt.</i></p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi realizohet sipas parashikimeve në kuadrin rregullator të UniBa.</i> - <i>Njësia përgjegjëse dhe personeli akademik monitorojnë me rigorozitet dhe përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën.</i> - <i>Rregullorja e UniBa parashikon të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me zhvillimin e provimit dhe vlerësimin në provim, por nuk parashikon ruajtjen e praktikës së ankimimit.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>			
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>		
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” është konceptuar të zhvillohet në dy vite akademike. Lëndët e përfshira në këtë program u mundësojnë studentëve marrjen e njohurive të thelluara në fushën e kontabilitetit dhe financës të fokusuar në disiplina si standardet e raportimit financiar, analiza financiare e avancuar, auditimi dhe legjislacioni tatimor.</p> <p>Duke iu referuar planit mësimor të programit të studimit konstatohet se veprimtaritë formuese të programit (puna në auditor dhe jashtë tij) janë përcaktuar kryesisht në funksion të formimit të studentëve, në zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të tyre.</p>		

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p><i>GVJ vlerëson se lëndët/modulet nga fusha e financës janë relativisht të kufizuara për të garantuar një thellim të njohurive në përputhje me profilin e programit të studimit prandaj rekomandon rritjen e lëndëve /moduleve nga kjo fushë qoftë edhe me zgjedhje.</i></p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Përfshirja në planin mësimor të këtij programi studimi të lëndëve si “Metoda Sasiore të Kërkimit”, “Ekonometri” dhe “Analizë financiare e avancuar” u mundëson studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe analizës kritike. Por GVJ konstaton se plani mësimor i këtij programi studimi nuk parashikon realizimin e orëve laboratorike të detyrueshme në këto lëndë.</p> <p><i>GVJ rekomandon që syllabuset e këtyre lëndëve duhet të rishihen dhe të reflektojnë aplikimin praktik të njohurive në orë laboratorike të detyrueshme si dhe të shihet mundësia e përfshirjes së një lënde mbi sistemet e informacionit.</i></p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kompetencat dhe aftësitë e studentit në këtë program studimi vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë zhvillimit të programit mësimor nëpërmjet diskutimeve në leksione dhe seminare, realizimit të detyrave/projekteve të kursit, si edhe në përfundim të lëndës me provimin përfundimtar, i cili sipas rregullores së UniBa, në varësi të specifikave të lëndës/modulit mund të zhvillohet me gojë, me shkrim ose i kombinuar (neni 88).</p> <p>Gjithashtu, në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se në përfundim të çdo lënde, pedagogu përkatës informon studentët mbi vlerësimin e vazhdueshëm të fituar gjatë semestrit si dhe mbi strukturën e provimit dhe çështjet kryesore ku duhet të fokusohen për provimin përfundimtar.</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të</p>	<p>Duke iu referuar planit mësimor të programit të studimit dhe programeve mësimore (syllabuseve) GVJ konstaton se lëndët “Metoda Sasiore të Kërkimit” dhe “Ekonometri” u mundësojnë studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë. Por siç u theksua edhe më sipër, syllabuset përkatëse nuk parashikojnë orë laboratorike të detyrueshme. Prandaj GVJ rekomandon rishikimin e këtyre syllabuseve.</p>

<p>përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Gjithashtu, praktika profesionale e parashikuar si detyrim akademik për t'u realizuar në semestrin e katërt, u mundëson studentëve të zhvillojnë aftësitë profesionale përmes zbatimit në një mjedis profesional real të njohurive teorike të marra në auditor.</p> <p>Në takimin, gjatë vizitës në institucion, me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit "Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë" me profil "Kontabilitet", GVJ konstatoi se ata mbështesin dhe nxisin diskutimet kritike të studentëve brenda kuadrit të këtij program studimi. Programet mësimore (syllabuset), të hartuara dhe zhvilluara prej tyre, nxisin bashkëpunimin dhe punën në grup të studentëve përmes detyrave dhe projekteve të kursit, prezantimeve të ndryshme dhe analizës së rasteve studimore.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; EVIDENCA 11.3 SYLLABUS UNIBA PAKETA E PRKTIKES MASTER PRILL 2021.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bzuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se pranë UniBa pedagogët e këtij programi studimi kanë zhvilluar leksione të hapura në bashkëpunim me profesionistë të ftuar mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të studimit. Leksionet e hapura janë jashtë strukturës së programit të studimit por pjesë e veprimtarive të parashikuara për vitin akademik nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjithashtu përmes instituteve dhe qendrave kërkimore të UniBa (si BIRD, AIPA, BEI, ADRIAPOL etj), mundësohet edhe përfshirja dhe mbështetja financiare e studentëve në projekte të ndryshme, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose përmes klubeve studentore të UniBa.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 4 A kalendari i aktiviteteve DEP. Ekonomise siper marrjes dhe finances.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstatoj se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit garanton marrjen e njohurive të thelluara dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve në fushën e kontabilitetit por duhet të shtohen lëndët/modulet nga fusha e financës. - Programi i studimit u mundëson studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, por plani mësimor i këtij programi studimi nuk parashikon realizimin e orëve laboratorike të detyrueshme. - Personeli akademik nxit bashkëpunimin dhe punën në grup të studentëve, si dhe përfshirjen e tyre në projekte të ndryshme. - Pranë UniBa zhvillohen leksione të hapura nga personeli akademik dhe përmes instituteve dhe qendrave kërkimore të UniBa, mundësohet edhe përfshirja dhe mbështetja financiare e studentëve në projekte të ndryshme, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose përmes klubeve studentore të UniBa.

Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushje pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X	


Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në dokumentacionin shoqëruar konstatohet se procedura e plotë për mënyrën e diplomimit të studentëve parashikohet në Rregulloren e UniBa dhe Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Konkretisht programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” përmbyllet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për të gjithë studentët. Rregullorja e UniBa është e publikuar në faqen zyrtare në internet të institucionit.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 13 UNIBA PAKETA E PROVES FINALE.pdf; https://umb.edu.al/upload/dossier/Rregullore-e-Uniba-NR.-27-1-DT2022.pdf]</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se Përgjegjësi dhe personeli akademik i Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës informojnë studentët mbi të gjithë procesin e diplomimit në programin master.</p> <p>Në Rregulloren e UniBa parashikohet që brenda tre muajve nga fillimi i vitit akademik, Departamenti përgjegjës për programin e studimit vë në dispozicion të studentëve të vitit të fundit temat orientuese të diplomave si dhe udhëzime për procedurat e përgatitjes dhe të mbrojtjes së punimit të diplomës.</p> <p>Si rregull drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga Departamenti dhe përzgjedhja dhe përgatitja e temës bëhet në përputhje me kërkesat e “Paketës së Provës Finale” të miratuar nga Senati i UniBa. Komisioni i mbrojtjes së diplomës, organizohet me jo më pak se tre anëtarë, propozohen nga Përgjegjësi i DESF dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 13 UNIBA PAKETA E PROVES FINALE.pdf; https://umb.edu.al/upload/dossier/Rregullore-e-Uniba-NR.-27-1-DT2022.pdf; vizita në institucion]</p>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.

<p>modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në takimet, gjatë vizitës në institucion, me studentët dhe personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”, GVJ konstatoi mbështetjen që studentët marrin nga personeli akademik përgjatë gjithë procesit të diplomimit.</p> <p>Biblioteka, laboratorët dhe ambiente të tjera të UniBa mund të shfrytëzohen nga studentët për studim të pavarur dhe për përgatitjen e temës dhe prezantimit të diplomës.</p> <p>Përmes takimeve të rregullta informuese, pedagogu udhëheqës e ndihmon për përgatitjen e propozimit dhe platformës së temës së diplomës, i rekomandon për literaturën dhe burimet e tjera të informacionit që studenti duhet të hulumtojë në funksion të temës, si dhe vlerëson ecurinë e studentit deri në përfundimin e punimit.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 13 UNIBA PAKETA E PROVES FINALE.pdf; https://umb.edu.al/upload/dossier/Rregullore-e-Uniba-NR.-27-1-DT2022.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Komisioni përkatës në përfundim të mbrojtjes së diplomës bën vlerësimin e studentit me notë (deri në 10) dhe me pikë në përqindje (deri në 100) të parashikuar në kuadrin rregullator të UniBa.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 13 UNIBA PAKETA E PROVES FINALE.pdf; EVIDENCA 14.1 SUPLEMENTI I DIPLOMES SHQIP ANGLISHT MASTER.pdf]</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ konstaton se në përfundim të studimeve në programin “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”, pasi studentit ka përfunduar të gjitha detyrimet e programit të studimit, si dhe detyrimet financiare ndaj UniBa pajiset me diplomën përkatëse, suplementin e diplomës dhe listën e notave sipas modelit të miratuar.</p> <p>Emërtimi dhe suplementi i diplomës janë në përputhje me programin e studimit të ndjekur nga studentit dhe me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Me kërkesë të studentëve vihet në dispozicion të tyre programi mësimor (syllabus) për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; EVIDENCA 14 URDHER NR 95 DT 23.03.2022 - FORMA E DIPLOMES MSC KONTABILITET.pdf; EVIDENCA 14.1 SUPLEMENTI I DIPLOMES SHQIP ANGLISHT MASTER.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se pranë sekretarisë mësimore të UniBa ruhet i gjithë dokumentacioni mbi studentët, në formë e dosjeve personale, edhe pas diplomimit në arkivën përkatëse bazuar në parimin e</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se pranë sekretarisë mësimore të UniBa ruhet i gjithë dokumentacioni mbi studentët, në formë e dosjeve personale, edhe pas diplomimit në arkivën përkatëse bazuar në parimin e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Ky dokumentacion vihet të dispozicion studentit me kërkesën e tij dhe mund të përdoret për konfirmime ndaj personave të autorizuar.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit të Brendshëm.pdf; Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 1.8 Rregullore protokol arkive.pdf; vizita në institucion]</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuadri rregullator i UniBa parashikon procedurën e diplomimit dhe institucioni vë në dispozicion të studentëve udhëzues për procedurën e diplomimit. - Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në procesin e përgatitjes së punimit të diplomës. - Në përfundim të ciklit të studimeve, studenti vlerësohet me notë dhe pajiset me diplomën dhe suplementin e saj. - Pranë UniBa dokumentacioni i studentit ruhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.
Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.

mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.							
Konkluzione	<i>Ky Standard nuk zbatohet për këtë program studimi.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet plotësisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet plotësisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Nga analiza e informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi disa mospërputhje lidhur me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” dhe pranë Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës. Gjatë vizitës në institucion, GVJ kërkoi si informacion shtesë përditësimin e tabelave me informacion mbi personelin akademik. Nga ky përditësim rezultoi se gjatë vitit akademik 2021-2022, për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej 12 pedagogë nga të cilët 7 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë (PAE) dhe 5 anëtarë të personelit akademik me kontratë (PAK). GVJ vlerëson se personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi zotëron përvojën dhe kryesisht kualifikimet e nevojshme për mësimdhënien dhe mbulimin e të gjitha aktiviteteve bashkëshoqëruese të një programi studimi Master.
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Numri dhe kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi për vitet 2019 – 2022 paraqitet si vijon:

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar gjithsej 12 pedagogë, nga të cilët 7 pedagogë si personel akademik me kohë të plotë (PAE): <ul style="list-style-type: none"> 2 Profesor 1 Profesor i Asociuar 1 Doktor i Shkencave 3 Msc <p>Personel akademik me kontratë janë 5 pedagogë, dy prej të cilëve mbajnë titullin Profesor i Asociuar dhe tre të tjerët mbajnë gradën Doktor i Shkencave. Raporti është 58% PAE dhe 42% PAK.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar gjithsej 8 pedagogë, nga të cilët 6 pedagogë si personel akademik PAE: <ul style="list-style-type: none"> 2 Profesor 2 Profesor i Asociuar 1 Doktor i Shkencave 1 Msc <p>Personel akademik me kontratë janë 2 pedagogë, një prej të cilëve mban titullin Profesor i Asociuar dhe një pedagog mban gradën Doktor i Shkencave. Raporti është 75% PAE dhe 25% PAK.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar gjithsej 9 pedagogë, nga të cilët 7 pedagogë si personel akademik PAE: <ul style="list-style-type: none"> 1 Profesor 2 Profesor i Asociuar 3 Doktor i Shkencave / PhD 1 Msc <p>Personel akademik me kontratë janë 2 pedagogë, një prej të cilëve mban titullin Profesor dhe një tjetër mban gradën shkencore Doktor i Shkencave. Raporti është 78% PAE dhe 22% PAK.</p> <p>Në fillim të vitit akademik 2022-2023 Rektori i UniBa ka nxjerrë një udhëzim për hartimin e ngarkesës mësimore në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, ekspertizën e personelit akademik, nevojat dhe hapësirat infrastrukurore të institucionit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Personeli efektiv i angazhuar pranë Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës plotëson kriteret lidhur me numri minimal që kërkohet nga Ligji nr. 80 2015, por raporti i personelit efektiv ndaj totalit të personelit akademik ka ardhur në rënie. ▪ Tre pedagogë të angazhuar në këtë program studimi gjatë vitit akademik 2021-2022 mbajnë kualifikimin Master. ▪ Fusha akademike-shkencore e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” përputhet me lëndët që ata mbulojnë në këtë program studimi.
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ka mospërputhje në raportimin e personelit akademik të angazhuar pranë këtij programi studimi dhe për Departamentin për vitin akademik 2021-2022 mes informacionit të dokumentacionit shtesë dhe informacionit të depozituar në sistemin e Ascal (në numër dhe në emër). <p><i>GVJ rekomandon që institucioni duhet të tregojë një kujdes të shtuar lidhur me angazhimin e personelit akademik në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi dhe duhet të plotësojë dokumentacionin përkatës në mënyrë të plotë dhe të qartë.</i></p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 2 PLANI MESIMOR NE mshk I NDRYSHUAR EM 20%.pdf; EVIDENCA 11.3 SYLLABUS.pdf; EVIDENCA 11.7 NGARKESA E STAFIT.pdf; EVIDENCA 23.2 CV STAFI AKADEMIK.pdf; EVIDENCA 27 TABELAT 1 - 24.pdf; Doc. Shtese Tabela personeli akademik ne PS MSH-K.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Kuadri rregullator i UniBa parashikon angazhimin e personelit akademik efektiv kundrejt kontratës së punësimit me kohëzgjatje të pacaktuar për kategorinë lektor dhe profesor dhe me kohëzgjatje një vit (e rinovueshme) për kategorinë asistent lektor, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.</p> <p>Nga shqyrtimi i informacionit shtesë, lidhur me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” në vitet akademike 2019-2022, GVJ konstaton një qëndrueshmëri relative të personelit akademik. Konkretisht për vitet akademike 2019-2022 mesatarisht 6 nga 12 pedagogë kanë vijuar angazhimin në këtë program studimi.</p> <p>Në takimet gjatë vizitës në institucion, me Dekanin dhe Përgjegjës të Departamentit, GVJ u informua se një pjesë e largimeve ishin për shkak të rritjeve në karrierë apo sfidave të tjera profesionale por edhe të kufizimeve në kualifikim të pedagogëve nga mos aktivizimi i programeve të doktoraturës për një kohë të gjatë. Gjithashtu drejtuesit u shprehën optimistë për ndryshimet e ndodhura në njësinë bazë dhe vijimësinë e qëndrueshme të personelit akademik.</p> <p><i>Pavarësisht rrethanave të largimeve, GVJ vlerëson se institucioni duhet të tregojë një kujdes të shtuar për të siguruar një qëndrueshmëri afatgjatë të personelit akademik në këtë program studimi, veçanërisht atij me kohë të plotë.</i></p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Doc. Shtese Tabela personeli akademik ne PS MSH-K.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,</p>	<p>Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik parashikohen në Statut (kreu V), në Rregulloren e UniBa (kreu IV) dhe në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Çdo fillim semestri departamenti që konstaton nevojën për personel të ri akademik, i paraqet kërkesën Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Përshkrimi i punës që përmban profilin profesional të personelit akademik, në varësi</p>

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>të ngarkesës dhe lëndës që pritet të mbulojë, hartohet nga Sekretari i Përgjithshëm i UniBa dhe Përgjegjësi i Departamentit të interesuar. Procesi vijon me publikimin e njoftimit në media dhe gjenerimin në fund të afatit të njoftimit, të listës së aplikantëve e cila shqyrtohet prapakisht nga komisioni i posaçëm i kryesuar nga Administratori i UniBa. Më pas procesi vijon me intervistat që finalizohen nga Komisioni i Vlerësimit, i përbërë nga Zv. Rektori, Adminstratori, Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit përkatës. Vendimi i komisionit i kalon për vlerësim përfundimtar Administratorit / Rektorit të UniBA. Për personelin akademik fitues kontrata nënshkruhet nga Rektori.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit te Burimeve Njerezore.pdf; Evidenca 22. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi se angazhimi i personelit ndihmës në këtë institucion ishte në nivelet minimale për shkak edhe të numrit të kufizuar të studentëve.</p> <p>Aktualisht, pranë Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës nuk ka të angazhuar personel ndihmës akademik dhe administrimi i laboratorëve të informatikës dhe mjediseve të tjera mësimore realizohej nga stafi i qendrës ICT dhe koordinohej nga sekretaria mësimore në nivel institucioni.</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni në organikën e tij ka ngritur Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerezore të organizuar me dy anëtarë – drejtuesi dhe një specialist. Kjo zyrë është në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm të UniBa dhe është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit me kohë të plotë dhe me kontratë. Veprimtaria e zyrës mbështetet në kuadrin rregullator të UniBa dhe në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerezore.</p> <p>Gjatë takimit me përfaqësuesin e kësaj zyre, GVJ konstatoi se kjo zyrë plotëson, ruan dhe përditëson të dhënat mbi anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron UniBa në formën e dosjeve personale të personelit.</p> <p>Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjen personale të dy pedagogëve të programit të studimit (një me kohë të plotë dhe një me kontratë) dhe konstatoi se dosja ishte e plotësuar me dokumentet e nevojshëm si: CV, kontrata e punës, diplomat dhe kualifikimet, librezat shëndetësore etj. Gjithashtu GVJ konstaton se në fillim të vitit akademik 2022-2023, me vendim të Rektorit të UniBa është miratuar lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe Koordinatori I Departamenti të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, të UniBa.</p>

	[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 1.7 Vendimi nr 29 dta 14.10.22 Korrdinatori i departamentit.pdf; Evidenca 7. Manuali i Menaxhimit te Burimeve Njerezore.pdf; vizita në institucion]		
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel institucioni me përfaqësues të institucioneve publike dhe jo-publike, të cilat mundësojnë edhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Në detyrat e Koordinatorit të departamentit parashikohet edhe ndihma ndaj studentëve lidhur me zhvillimin e praktikës profesionale, përgatitjen për zgjedhjen e temës së diplomës, si dhe ndihmë për çështje të tjera të lidhura me aktivitete të programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të UniBa janë përgatitur “Paketa e Praktikës Master” dhe “Paketa e Provës Finale” të miratuar nga Senati i UniBa që ndihmojnë studentët në procesin e praktikës dhe përgatitjes së temës së diplomës si dhe mbikëqyrësit përkatës në procesin e vlerësimit të tyre.</p> <p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, ata konfirmuan se institucioni u kishte ofruar mbështetje për gjetjen e vendit të praktikës, megjithëse shumica e kishte gjetur vetë, pasi ishin të punësuar që gjatë viteve të studimit.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 5. Paketa e proves finale.pdf; EVIDENCA 10 LISTA E STUDENTEVE DHE E INSTITUCIONEVE KU KANE ZHVILLUAR PRAKTIKEN PROFESIOALE.pdf; EVIDENCA 11.3 SYLLABUS UNIBA PAKETA E PRKTIKES MASTER PRILL 2021.pdf; EVIDENCA 22 TE DHENA TABELORE PER MARREVESHJET E BASHKEPUNIMIT.pdf; vizita në institucion]</p>		
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi ka kryesisht nivelin e kërkuar të kualifikimit akademik për mësimdhënien në programin e studimit Master. - Pranë Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës ka qëndrueshmëri relative të personelit akademik efektiv dhe atij të angazhuar në këtë program studimi. - Në UniBa personeli ndihmës është në nivele minimale dhe pranë Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës nuk ka personel ndihmës apo ndihmës-akademik. - Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të UniBa mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe me kontratë. - UniBa ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale dhe ka përgatitur udhëzues për realizimin dhe vlerësimin e praktikës profesionale dhe të temës së diplomës. 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht


Standardi IV.2															
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.															
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve														
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi se programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” e zhvillon aktivitetin mësimor në Kampusin 2 që ndodhet në Rrugën Frang Bardhi. GVJ vlerëson se mjediset në këtë ndërtesë janë të mjaftueshme dhe të pajisuara me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor.</p> <p>Të dhënat në vijim i referohen përmbledhtas mjediseve kryesore në dispozicion të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>MJEDISI</th> <th>NR. I SALLAVE</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td>Salla seminari / aktivitete</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Laboratorë</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Zyra për personelin akademik</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Bibliotekë / Internet</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Ambiente ndihmëse në përdorim të përbashkët (kancelari/zyra shërbimi/ të tjera ndihmëse)</td> <td>5</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe seminaresh, bibliotekën dhe mjediset të tjera në përdorim të përbashkët dhe vuri re që mjediset, sipas funksionit të tyre, ishin të pajisura edhe me kompjutera, projektorë dhe lidhje interneti, si dhe kishin ndriçim dhe ajrosje optimale për kryerjen e aktivitetit mësimor.</p> <p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas kuadrit rregullator në fuqi.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit të Brendshëm.pdf; EVIDENCA 24 RAPORT I EKSPERTIT PER INFRASTRUKTUREN.pdf; EVIDENCA 27 TABELAT 1 - 24.pdf; vizita në institucion]</p>	MJEDISI	NR. I SALLAVE	Salla leksioni	11	Salla seminari / aktivitete	6	Laboratorë	2	Zyra për personelin akademik	3	Bibliotekë / Internet	5	Ambiente ndihmëse në përdorim të përbashkët (kancelari/zyra shërbimi/ të tjera ndihmëse)	5
MJEDISI	NR. I SALLAVE														
Salla leksioni	11														
Salla seminari / aktivitete	6														
Laboratorë	2														
Zyra për personelin akademik	3														
Bibliotekë / Internet	5														
Ambiente ndihmëse në përdorim të përbashkët (kancelari/zyra shërbimi/ të tjera ndihmëse)	5														
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor, GVJ konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar dhe nuk parashikon realizimin e orëve të detyrueshme laboratorike.</p> <p>Në funksion të programeve të studimit të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë janë edhe dy laboratorë informatike, të cilët</p>														

objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	sikurse dhe sallat e leksionit dhe të seminarit janë të pajisur me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për tu shfrytëzuar nga të gjithë studentët për studim dhe aftësimin praktik në teknologji informacioni, si dhe për realizimin e detyrave të kursit dhe temës së diplomës. [Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 27 TABELAT 1 - 24.pdf; vizita në institucion]		
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel institucioni me përfaqësues të institucioneve publike dhe jo-publike, të cilat mundësojnë edhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi në mjedise të përshtatshme. [Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; vizita në institucion]		
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.	GVJ konstaton se: - UniBa ka ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore. - Klasat e leksioneve dhe të seminareve dhe ambientet e tjera janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një proces mësimor bashkëkohor. - Në dispozicion të studentëve janë 2 laboratorë informatike dhe ambiente të tjera në përdorim të përbashkët të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme në shërbim të tyre. - Praktika profesionale zhvillohet në mjedise të përshtatshme sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura në nivel institucioni.		
Konkluzione			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe	Bazuar në programet e lëndëve / moduleve GVJ konstatoi se titujt e përfshirë në literaturën bazë dhe ndihmëse të programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet”



<p>njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>përbushin objektivat e tij të studimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, kryesisht të autorëve shqiptarë, por edhe përkthime në shqip të autorëve të huaj. Krahas literaturës në gjuhën shqipe, në syllabus studentëve u sugjerohet edhe literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj (në gjuhën angleze) në funksion të thellimit të njohurive të fushës.</p> <p>Në takimin me personelin akademik, GVJ mori konfirmimin se në fillim të çdo viti akademik, pedagogët bëjnë rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve të lëndëve dhe secili departament paraqet propozimin për listën e librave të nevojshëm për procesin mësimor dhe që duhet t'i shtohen fondit të bibliotekës.</p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; EVIDENCA 17.10 KERKESE PER LIBRA BIBLITEKE.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Pranë UniBa, biblioteka në dispozicion të studentëve është e organizuar në të dy kampuset, me ambient kryesor të pajisur me hapësira pune për lexim dhe përdorim të kompjuterit si dhe ambiente ndihmëse me përdorim multifunksional. Studentët dhe pedagogët e këtij programi studimi, shfrytëzojnë kryesisht bibliotekën në katin e parë të Kampusit 2, me sipërfaqe 27.3m², me 18 hapësira leximi dhe 5 vende pune me kompjuter, si dhe hapësirën multifunksionale të revistave dhe të periodikëve me sipërfaqe 95.1m². Biblioteka ofron infrastrukturën e nevojshme për akomodim dhe shfrytëzim optimal në mënyrë të barabartë nga studentët dhe pedagogët e të gjithë programeve të studimit të UniBa.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se biblioteka ishte e pasur me literaturë fizike, në shqip dhe gjuhë të huaj, të disiplinave të ndryshme të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të UniBa. Gjithashtu, GVJ konstatoi se Biblioteka dispononte kopje të librave që rekomandohen në literaturën e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 17.9 TE DHENA PER INFRASTRUKTUREN E BIBLIOTEKES, LISTA.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi na u konfirmua se ata kanë mundësi të përdorin pa pagesë si literaturën fizike të disponueshme në bibliotekë por edhe bibliotekën elektronike, në ambientet e UniBa. Falë marrëveshjeve të bashkëpunimit, institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik disa platforma të bibliotekave elektronike si EconBiz, JSTOR, SpringerLink etj.</p> <p><i>[Referenca: Aneks 8. Platforma e bibliotekës online.pdf; EVIDENCA 17.3 UDHEZUES PER PERDORIMIN E STRUKTURES SE TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT - UNIBA - 2021.pdf; https://umb.edu.al/biblioteka.html; EVIDENCA 17.8 BIBLIOTEKA ONLINE.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që</p>	<p>Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës në Kampusin 2, GVJ konstatoi se biblioteka është e pajisur me 5 vende pune me kompjuter, që mund të</p>

mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	përdoren nga studentët për të kërkuar dhe shfrytëzuar literaturën fizike të bibliotekës por edhe për t'u lidhur me platformat e bibliotekave elektronike si EconBiz, JSTOR etj për të hulumtuar në funksion të realizimit të projekteve, detyrave të kursit dhe temës së diplomës.		
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Përmes platformës digjitale të menaxhimit të librit, të integruar në faqen web të UniBa, studentët dhe pedagogët mund të bëjnë kërkimin dhe rezervimin e librave që ndodhen në katalogun e bibliotekës edhe në distancë.</p> <p>Shërbimi i bibliotekës ofrohet nga e hëna deri të premte, në intervalin 08.00-19.45, në përputhje me nevojat e studentëve të këtij programi studimi por edhe të studentëve të programeve të tjera.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 17.3 UDHEZUES PER PERDORIMIN E STRUKTURES SE TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT UNIBA 2021.pdf; vizita në institucion]</p>		
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ vlerëson se institucioni angazhohet në mënyrë aktive lidhur me cilësinë e fondit fizik të bibliotekës, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të saj. Një ndër objektivat e planit për zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2020-2030 të UniBa, është dhe përditësimi i vijueshëm i bibliotekës me literaturë bashkëkohore.</p> <p>Në ambientet e bibliotekës zhvillohen aktivitete në bashkëpunim me klubet studentore të UniBa, si Klubi i Librit, që synojnë të nxisin shkallën e shfrytëzimit të saj.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te institucional 2020-2030.pdf; EVIDENCA 17.9 TE DHENA PER INFRASTRUKTUREN E BIBLIOTEKES, LISTA.pdf; EVIDENCA 17.10 KERKESE PER LIBRA BIBLITEKE.pdf; https://biblioteka.umb.edu.al/; vizita në institucion]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Literatura bazë dhe ndihmëse e programit përmbushin objektivat e tij të studimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program. - Biblioteka ofron infrastrukturën e nevojshme për akomodim dhe shfrytëzim optimal në mënyrë të barabartë nga studentët dhe pedagogët e të gjithë programeve të studimit të UniBa. - Institucioni angazhohet në mënyrë aktive lidhur me cilësinë e fondit fizik të bibliotekës, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të saj. 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi se institucioni përdor disa platforma online për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre të kombinuar me sistemin tradicional të bazuar në dokumentacionin në formatin letër dhe elektronik dhe të dosjeve përkatëse të studentëve. Sipas kuadrit rregullator të UniBA, informacioni që lidhet me studentët nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre administrohet nga sekretaria mësimore dhe dokumentacioni ruhet në formatin fizik dhe elektronik në sekretari.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretari GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen e plotë të dy studentëve të programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” dhe përdorimin e regjistrave përkatës (themeltar, të arritjeve akademike & të lëshimit të diplomave) sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, përfaqësuesi i qendrës së TIK pranë UniBa, konfirmoi përdorimin e disa platformave për administrimin dhe komunikimin e informacionit në institucion si Portali Studentor, Intranet, Platforma Google Classroom & GSuite dhe faqja web zyrtare.</p> <p>Portali studentor siguron akses të dedikuar për studentët, personelin akademik dhe administrativ të UniBa, në përputhje me ligjin e ruajtjes së privatësisë së informacionit personal.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Intranet kryesisht i referohet komunikimit të brendshëm dhe ruajtjes së dokumentave të kategorizuar sipas njësive dhe të disponueshëm sipas hierarkisë së të drejtave në sistem.</p> <p>Platforma Google Classroom & GSuite, e përdorur fillimisht gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, tashmë përdoret për prezantimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore nga personeli akademik tek studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Faqja zyrtare e UniBa dhe rrjetet sociale përdoren për komunikimin me publikun e gjerë.</p> <p>[Referenca: Aneks 1&2. Manuali i përdorimit të Google Classroom.pdf; Aneks 3. Manuali i përdorimit të GSuit.pdf; Aneks 4. Manuali i përdorimit të Intranet.pdf; Aneks 5.1 Manuali i përdorimit të portalit Studentor për administrim.pdf; EVIDENCA 17.3 UDHEZUES PER PERDORIMIN E STRUKTURES SE TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT UNIBA 2021.pdf; vizita në institucion]</p>

<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ vlerëson se sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të UniBa. Gjatë vizitës në institucion, përfaqësuesi i qendrës së TIK pranë UniBa konfirmoi gjithashtu se po punohej për integrimin e platformave në një sistem të vetëm menaxhimi të informacionit (cluster) i cili do t'u mundësojë drejtuesve dhe titullarëve të institucionit të dhëna dhe raportime në kohë reale dhe në distancë.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 17.3 UDHEZUES PER PERDORIMIN E STRUKTURES SE TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT UNIBA 2021.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet që lidhen me procesin mësimor, projektet dhe aktivitetet kërkimore-shkencore, broshura të ndryshme promovuese të UniBa publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet, kryesisht në gjuhën shqipe. Në gjuhën angleze rezulton i publikuar vetëm një pjesë e informacionit.</p> <p>[Referenca: https://feqd.umb.edu.al/; https://umb.edu.al/en/; vizita në institucion]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Institucioni përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë UniBa. - Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të UniBa. - Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet, broshura të ndryshme promovuese të UniBa publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të kostove sipas njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit por harton një raport financiar në nivel universiteti dhe për periudha vjetore që përkojnë me vitin financiar, i cili fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.</p> <p>Sipas parashikimeve në Statutin e UniBa (nenet 35 & 39), Administratori i institucionit harton projekt buxhetin vjetor mbi propozimet e njësisë kryesore dhe të njësisë bazë në mbështetje të planit strategjik të zhvillimit të institucionit dhe planin buxhetor afatmesëm të tij. Këto dokumenta më pas miratohen nga Bordi i Administrimit i UniBa, që mbikëqyr edhe zbatimin e tyre.</p> <p>GVJ konstaton se Zyra e Financës, strukturë në varësi të Administratorit të UniBa, harton raportin vjetor financiar dhe bën një parashikim të të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara për vitin akademik pasardhës (projekt buxheti). Në këto raporte financiare të ardhurat janë të klasifikuara sipas burimeve kryesore të financimit të UniBa: nga aktiviteti kryesor (tarifat e studentëve) dhe nga aktivitete të tjera në përputhje me objektin e aktivitetit të shoqërisë Barleti Group shpk, që administron UniBa.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Gjithashtu, shpenzimet janë të klasifikuara sipas natyrës së tyre: në shpenzime për personelin, shpenzime operative, shpenzime për infrastrukturën, shpenzime për aktivitete kërkimore-shkencore, projektet etj.</p> <p><i>GVJ nuk konstatoi ndonjë analizë të planit të financimit në nivel njësie bazë apo kryesore prandaj rekomandon hartimin e raporteve financiare në nivel programi studimi për një analizë më të plotë dhe domethënëse në funksion të optimizimit të burimeve për realizimin e programeve të studimit pranë UniBa.</i></p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 6 te dhena nga raporti financiar vjetor institucional.pdf; Info. shtesë: Evidenca 26. Burimet Financiare te UniBa-s.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Universiteti Barleti është institucion jo publik i arsimit të lartë në pronësi të shoqërisë tregtare “Barleti Group” shpk., për pasojë aktiviteti tregtar rregullohet edhe nga Ligji Nr.9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, i ndryshuar. Shoqëria ka detyrim ligjor përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Ligjin Nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi</p>	

<p>realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Financiare“ si dhe publikimin e tyre pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Sipas parashikimeve në Statutin e UniBa (neni 39), Administratori i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit në përfundim të vitit akademik. Gjithashtu, kuadri rregullator i UniBa (neni 63 i Statutit) parashikon kontrollin dhe auditimin e brendshëm të aktivitetit financiar të institucioni nga struktura e auditimit të brendshëm. Bazuar në RVB dhe dokumentacionin shoqërues GVJ konstaton se gjatë vitit 2022, i është nënshtruar auditimit të brendshëm nga struktura përkatëse e institucionit. Gjithashtu që prej vitit 2017 pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare “Barleti Group“ shpk i nënshtrohen auditimit të jashtëm nga shoqëria audituese Grant Thornton shpk. Për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021, audituesi i jashtëm shprehet (opinion) se pasqyrat financiare individuale të Barleti Group shpk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. <i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 6.3 Raporti i audituesve te pavarur dhe pasqyrat financiare.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Sipas Statutit të UniBa (neni 35) Bordi i Administrimit garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe përmbushjen e misionit të tij. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se institucioni në tre vitet financiare të fundit (2019-2021) rezulton fitimprurës dhe me opinion të konfirmuar nga audituesi i jashtëm. Gjithashtu në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2020-2030 të UniBa theksi vihet në pasurimin e programeve të studimit, rritjen e cilësisë dhe garantimin e vijimësisë dhe qëndrueshmërisë institucionale. <i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit te institucional 2020-2030.pdf; Evidenca 6 te dhena nga raporti financiar vjetor institucional.pdf; Info. shtesë: Evidenca 26. Burimet Financiare te UniBa-s.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UniBa harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator por në nivel universiteti dhe nuk bën analiza financiare në nivel njësie kryesore/ bazë apo sipas programeve të studimit. - Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm nga struktura përkatëse në varësi të Administratorit të UniBa dhe çdo vit pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare Barleti Group shpk auditohen nga audituesi i jashtëm. - UniBa garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Përbushet	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve të programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe Statutin e UniBa.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja e njësisë kryesore, rregullorja e njësië bazë dhe rregullorja e programit të studimit parashikojnë qartë kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në programe të tjera.</p> <p>Statuti dhe Rregullorja e UniBa garantojnë barazinë të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit bazuar në meritat personale, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore dhe përjashtimin e çdo lloj diskriminimi (përkatësisht neni 3).</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 1 Rregullore e FEQD.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; EVIDENCA 1.3 RREGULLORE DESF.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Në Statutin dhe në rregulloret e UniBa, parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera.</p> <p>Sipas parashikimeve në këto rregullore, për çdo vit akademik Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës propozon kriteret e përzgjedhjes në programin e studimit “Master i Shkencave në</p>

<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kontabilitet-Financë“ me profil “Kontabilitet”, të cilat më pas miratohen nga Senati Akademik i UniBa. Aktualisht, pranimi në këtë program studimi është i mundur për studentët që zotërojnë një diplomë të Ciklit të Parë të studimeve pranë një IAL brenda ose jashtë vendit (të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga MAS), si dhe dëshmojnë njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian, sipas nivelit të përcaktuar në aktet rregullatore të MAS.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kriteret dhe kuotat e pranimit të studentëve, pas marrjes së miratimit sipas kuadrit rregullator, bëhen publike nga UniBA përpara fillimit të aplikimeve për pranimet në ciklin e dytë të studimeve përmes publikimeve në ambientet e universitetit, fletëpalosjeve dhe broshurave informuese, publikimeve në faqen zyrtare web të institucionit, në media dhe në rrjetet sociale, si dhe takimeve të drejtpërdrejta me të interesuarit. I gjithë procesi, menaxhohet dhe koordinohet nga Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, strukturë në varësi të zv/Rektorit për Çështjet Studentore dhe Komunitetin e krijuar në vitin 2018 dhe që zhvillon aktivitetin në përputhje me kërkesat e Rregullores së UniBa dhe sipas manualit përkatës të zyrës.</p> <p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit.</p> <p>[Referenca: Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 13.0 VENDIM SENATI - KRITERET E PRANIMIT TE STUDENTEVE NE 20202 - 2021.pdf; EVIDENCA 18, MANUAL PER REKRUTIMIN, APLIKIMIN, REGJISTRIMIN DHE TRANSFERIMIN E STUDENTEVE NE UNIVERSITETIN BARLETI.pdf; https://umb.edu.al/pranimet.html]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i UniBa nuk ka parashikime specifike për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, por respekton kuadrin ligjor në fuqi dhe Udhëzimet e MAS.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Gjithashtu, në kuadrin rregullator të UniBa parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit edhe të studentëve të huaj, por që plotësojnë kriteret e përgjithshme të programit të studimit dhe në respektim të Udhëzimeve të MAS, pa vendosur kriteret të tjera specifike.</p> <p>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf]</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për të rritur cilësinë në programet e tij të studimit përmes aplikimit të tarifave të reduktuara dhe të bursave për studentët cilësorë. Gjithashtu, parashikohet edhe aplikimi i bursave të pjeshme si bursa sociale për studentët nga shtresa në nevojë.</p>

	[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; https://umb.edu.al/upload/pdf/Formular-Aplikimi-per-Burse-Master.pdf ; vizita në institucion]		
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në kuadrin rregullator të UniBa parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet master, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. - Kriteret dhe kuotat e pranimit të studentëve, bëhen publike nga UniBA përpara fillimit të aplikimeve për pranimet në ciklin e studimeve master. - UniBa respekton kuadrin rregullator në fuqi lidhur me pranimin e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakicave, shtresave në nevojë dhe kandidatëve nga shtete të tjera. - UniBa angazhohet në aplikimin e bursave dhe tarifave të reduktuara për studentët cilësorë dhe nga shtresa në nevojë. 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi të studimeve. Rregullorja e UniBa dhe Rregullorja e Brendshme për Transferimin japin informacion të plotë lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe periudhave të mëparshme të studimit. Në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, procesi i njohjes së kualifikimeve të mëparshme është kompetencë e komisionit <i>ad-hoc</i> të ngritur me propozim të Departmentit përgjegjës për programin e studimit dhe me vendim të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes & Drejtësisë. Komisioni <i>ad-hoc</i> pasi shqyrton dosjet e kandidatëve për transferim studimesh dhe për program të dytë studimi, jep vlerësimin bazuar në kuadrin rregullator të UniBa dhe Udhëzimet e MAS.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” informohen në lidhje me programin e studimit, organizimin e vitit akademik dhe kuadrin rregullator përkatës

	<p>që në momentin e regjistrimit pranë UniBa, si dhe më pas në mënyrë të vazhdueshme nga personeli akademik i Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës, nga Koordinatori i Departamentit, nga Sekretaria Mësimore, nga Zyra e Shërbimeve Studentore dhe faqja zyrtare në internet e UniBa.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; Evidenca 35. Rregullore e Brenshme per Transferimet.pdf; https://umb.edu.al/transferohu.html; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në kuadrin rregullator të UniBa jepet informacion i plotë mbi vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin e provimit të zhvilluar për lëndën në përfundim të semestrit. Programet e lëndëve (syllabuset) janë të hartuara në bazë të rregulloreve të institucionit dhe udhëzimit të MAS dhe përmbajnë kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në këtë program studimi. Këto kriteret dhe procedura u komunikohen studentëve nga pedagogët gjatë orës së parë të mësimit ku u paraqitet programi i lëndës.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi ishte pothuajse i harmonizuar (me përjashtim të një lënde) sipas parashikimeve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 50% nga vlerësimi i aktiviteteve gjatë semestrit akademik ku përfshihen frekuentimi, aktivizimi në seminare dhe kontrollet e tjera të vijueshme si teste, raste studimore, detyra dhe projekte kursi; ▪ 50% nga vlerësimi në provimin në fund të semestrit.
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” parashikon mbylljen e studimeve me provën finale, e cila është në formën e një punimi diplome (neni 16 pika 2).</p> <p>Në Rregulloren e UniBa parashikohet që brenda tre muajve nga fillimi i vitit akademik, Departamenti përgjegjës për programin e studimit vë në dispozicion të studentëve të vitit të fundit temat orientuese të diplomave si dhe udhëzime për procedurat e përgatitjes së temës së diplomës në programin master.</p> <p>Si rregull drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga Departamenti dhe përzgjedhja dhe përgatitja e temës bëhet në përputhje me kërkesat e “Paketës së Provës Finale” të miratuar nga Senati i UniBa.</p> <p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët ishin të informuar mbi të gjithë procesin e diplomimit në ciklin master me temë diplome.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 5. Paketa e proves finale.pdf; Evidenca 3.0 Rregullore e programit MSHFK.pdf ; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike,</p>	<p>Gjatë vizitës së institucion, GVJ u informua se në çdo vit akademik, përmes Zyrës së Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, UniBa merr</p>

<p>institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>pjesë në aktivitete, panaire dhe organizon vizita në institucion ku maturantët dhe studentët e rinj njihen me programet e studimit, pedagogët, ambientet dhe mundësitë që ofron UniBa. Gjithashtu, në faqen zyrtare në internet publikohen informacione mbi të gjitha programet e studimit dhe njoftime të tjera informuese për studentët e ardhshëm.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlerimit të Brendshëm.pdf; Guida te studenteve UNIBA.pdf; https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/UNIBA-BROCHURE-2022-SQ.pdf; vizita në institucion]</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UniBa vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe mbi procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. - UniBa vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi dhe procesin e diplomimit. - UniBa merr pjesë dhe organizon aktivitete informuese për studentët. 								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="603 869 798 952">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="798 869 992 952">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="992 869 1219 952">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1219 869 1457 952">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi se informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve bëhet në takimet informuese para dhe gjatë periudhës së regjistrimit të studentëve, si dhe përmes publikimit të informacionit në ambientet e UniBa, në faqen zyrtare në internet dhe në rrjetet sociale.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjithashtu, këtë informacion studentët e marrin edhe në takimin prezantues me drejtuesit e UniBa dhe personelin akademik në ditën e parë të mësimit për vitin akademik.</p> <p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit vë në dispozicion të studentëve planin mësimor dhe programet e lëndëve (syllabuset), ku paraqitet informacioni mbi përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit. Gjatë orës së parë të çdo lënde, pedagogët prezantojnë studentët me objektivat e lëndës, njohuritë që do të marrin</p>

	<p>në lëndën përkatëse, literaturën ku do të mbështeten dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 11. SYLLABUS.pdf; Guida te studenteve UNIBA.pdf; vizita në institucion]</p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se UniBa informon dhe orienton studentët mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet strukturave si Dekani i Studentëve dhe Zyra e Alumni & Karrierës, si dhe personeli akademik dhe Koordinatorit i Departamentit përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>Për këtë qëllim, në bashkëpunim edhe me njësi të tjera mbështetëse të Grupit Barleti organizohen aktivitete të ndryshme për orientimin e studentëve në tregun e punës.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 39. Rregullore e zyrave studentore alumni dhe karriera.pdf; 2.1. Plani Punes 2021-22 Zyra Alumni dhe Karriera.pdf; https://umb.edu.al/karriera.html; vizita në institucion]</p>		
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Koordinatori i Departamentit, Sekretaria Mësimore, Zyra e Shërbimeve Studentore dhe pedagogët e Departamentit përgjegjës për programin e studimit, u mundësojnë studentëve informacion të përditësuar edhe lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>UniBa u ka mundësuar studentëve që të informohen lidhur me programin e studimit në çdo kohë dhe në distancë përmes faqes zyrtare në internet dhe logimit në Portalin e studentit, i cili është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët në çdo kohë dhe distancë.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; https://studentportal.umb.edu.al/; vizita në institucion]</p>		
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve bëhet në takimet informuese para dhe gjatë periudhës së regjistrimit të studentëve, si dhe përmes publikimit të informacionit në ambientet e UniBa, në faqen zyrtare në internet dhe në rrjetet sociale. - Departamenti përgjegjës për programin e studimit vë në dispozicion të studentëve informacionin mbi përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit. - Struktura si Dekani i Studentëve dhe Zyra e Alumni & Karrierës, si dhe personeli akademik dhe Koordinatorit i Departamentit përgjegjës për programin e studimit informon dhe orienton studentët mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi. - Informimi në distancë realizohet edhe përmes portalit studentor. 		
<p>Konkluzione</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UniBa mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi.</p>																
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore e UniBa mbledh, regjistron dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të tyre gjatë ciklit të studimeve dhe diplomimin e tyre. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ konstatoi se Regjistri themeltar, Regjistri i lëshimit të diplomave dhe Regjistri i arritjeve akademike, janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve shtetërore. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” dhe konstatoi plotësinë e tyre.</p>																
	<p>Në vijim paraqiten të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për periudhën 2019-2022:</p> <table border="1" data-bbox="619 1160 1444 1339"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar për herë të parë</th> <th>Transferime</th> <th>Të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>16 studentë</td> <td>4 studentë</td> <td>10 studentë</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>24 studentë</td> <td>1 student</td> <td>17 studentë</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>12 studentë</td> <td>1 student</td> <td>në proces</td> </tr> </tbody> </table> <p>Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi në harkun kohor 2019-2022 janë të regjistruar me numër matrikullimi me përjashtim të një studenti (viti akademik 2020-2021) që rezultoi i larguar. [Referenca: EVIDENCA 9.2 RREGULLORE E SEKRETARISE MESIMORE.pdf; vizita në institucion]</p>	Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Transferime	Të diplomuar	2019-2020	16 studentë	4 studentë	10 studentë	2020-2021	24 studentë	1 student	17 studentë	2021-2022	12 studentë	1 student	në proces
Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Transferime	Të diplomuar														
2019-2020	16 studentë	4 studentë	10 studentë														
2020-2021	24 studentë	1 student	17 studentë														
2021-2022	12 studentë	1 student	në proces														
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Veprimtaria e sekretarisë mësimore rregullohet nga Rregullorja e UniBa (kreu 3) dhe nga Rregullorja e Sekretarisë Mësimore. Sekretaria mësimore ruan dokumentacionin lidhur me të dhënat e studentëve nga momenti i regjistrimit deri në momentin e largimit/diplomimit të tyre: regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave me shkrim dhe elektronik. Të gjitha të dhënat statistikore të studentëve (numri i matrikullimit, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, vlerësimi i arritjeve të studentëve dhe të dhëna të tjera personale) ruhen në sistemin e brendshëm të informacionit</p>																

	<p>dhe aksesohen lehtësisht nga personat e autorizuar. Manaxhimi elektronik i të dhënave bëhet nëpërmjet portalit të studentit, ku çdo person i autorizuar mund të aksesojë dhe verifikojë lehtësisht informacionin. Të dhënat ruhen edhe në formatin letër në dosjet personale të studentëve dhe në regjistrat përkatës që plotëson sekretaria mësimore.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 9.2 RREGULLORE E SEKRETARISE MESIMORE.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ nuk konstatoi ndonjë akt institucional apo raport të dedikuar lidhur me kontrollin periodik pranë strukturave që merren me menaxhimin apo ndonjë vlerësim periodik të saktësisë së informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtaritë përkatëse përveç raporteve të përgatitura nga Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë (NJZHKC) dhe Raportit të Analizës Vjetore të Departamentit.</p> <p>Në Raportet NJZHKC bëhet vlerësimi periodik i veprimtarisë së UniBa, bazuar në analizën e formularëve të vlerësimit (pyetësorëve). Në Raportin vjetor të Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes & Financës përfshihen edhe disa statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar sipas viteve në programet e studimit që ofrohen nga ky departament. Raporti është kryesisht përshkruar i veprimtarisë së departamentit gjatë vitit akademik përkatës dhe përfshin objektivat dhe aktivitetet për vitin akademik pasues.</p> <p><i>GVJ rekomandon që institucioni duhet të përgatisë raporte më të plota dhe të dedikuara në funksion të plotësimit të kërkesave specifike të kësaj fushe dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit në përgjithësi.</i></p> <p>[Referenca: 1.1. Analiza Vjetore DEFS (2 vitet fundit).pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p><i>GVJ rekomandon që institucioni duhet të përgatisë raporte më të plota dhe të dedikuara në funksion të plotësimit të kërkesave specifike të kësaj fushe dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit në përgjithësi.</i></p> <p>[Referenca: 1.1. Analiza Vjetore DEFS (2 vitet fundit).pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UniBa mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. - Sistemi aktual i menaxhimit mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. - Në raportin vjetor të punës së njësive bazë përfshihen statistika të thjeshta mbi studentët, si dhe objektivat dhe aktivitetet për vitin akademik pasues. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se UniBa ka mundur angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta, në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë si edhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të institucionit.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në Statutin dhe Rregulloren e UniBa parashikohet e drejta e studentëve për t'u organizuar në Këshilla Studentorë. Qeveria studentore është organizim i studentëve të UniBa të angazhuar në promovimin, koordinimin dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve dhe përfaqësimit të ideve dhe opinionëve të tyre në organet drejtuese të UniBa si dhe për garantimin e funksionimit të klubeve studentore dhe për zhvillimin e veprimtarive të tjera kulturore artistike. <i>[Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf; Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 37. Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentet dhe strukturat organizative të tyre.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në 64epartment, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Përveç përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, përmes strukturave të garantuara nga kuadri rregullator i UniBa, GVJ konstatoi se institucioni përdor edhe formularët për studentët (pyetësorët) për vlerësimin e procesit akademik dhe të personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Pas përpunimit të pyetësorëve nga NJZHKC, rezultatet përfshihen në analizën dhe raportin që përgatit kjo njësi, si dhe u komunikohet të gjitha strukturave të institucionit.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësies/pedagogut përgjegjës.	Gjithashtu, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UniBa u jep siguri studentëve për barazi dhe paanshmëri në vlerësimin e njohurive. Në Rregulloren e UniBa, në kreun 7-të (nenet 89-90), parashikohet e drejta e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me zhvillimin e provimit dhe vlerësimin në provim, kundrejt një kërkesë me shkrim që i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit. Ankesa për procesin duhet të paraqitet 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit, ndërsa ankesa për vlerësimin duhet të paraqitet brenda 48 orëve nga komunikimi i rezultateve të provimit. Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me komisionin e provimeve bëjnë verifikimet dhe rishikimin sipas situatës. Në raste të problematikave të veçanta, Përgjegjësi i Departamentit vë në dijeni Dekanin e FEQD, i cili brenda 48 orëve nga njoftimi vijon me

	<p>ngritjen e një komisioni të posaçëm <i>ad-hoc</i> për të bërë verifikimet e nevojshme lidhur me ankesën e studentit.</p> <p><i>GVJ konstatoi që kuadri rregullator aktual i UniBa nuk parashikon ruajtjen e praktikës së ankimit, përfshirë komunikimet mes palëve dhe dokumentacionin e shqyrtuar, në përfundim të procesit. Pavarësisht mungesës së problematikave serioze lidhur me ankimet e studentëve, GVJ rekomandon përditësimin e kuadrit rregullator të UniBa edhe për këtë aspekt.</i></p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 23. 1 Raporti i vlerësimit të studentëve 21-22 sem II.pdf; vizita në institucion]</i></p>						
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UniBa ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta, në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë si edhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të institucionit.</i> - <i>GVJ konstatoi se institucioni përdor edhe pyetësoin për studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin.</i> - <i>Kuadri rregullator i UniBa, parashikon të drejtën e ankimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe/ ose vlerësimin në provim.</i> 						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Në Rregulloren e UniBa nenet 31-39 parashikojnë njësitë përgjegjëse për pritjen, orientimin, këshillimin dhe menaxhimin e problematikave të studentëve, si edhe funksionet përkatëse të tyre. Këto njësi janë në varësi të Zv/Rektorit për çështjet Studentore dhe Komitetin dhe përbëhen nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zyra e Rekrutimit, Pranimi & Regjistrimit; ▪ Zyra e Dekanit të Studentëve; ▪ Zyra Alumni dhe Karriera. <p>Gjithashtu, Sekretaria Mësimore dhe Koordinatorin e Departamentit, së bashku me stafin akademik të programit të studimit informojnë studentët mbi të gjitha aktivitetet që lidhen me procesin mësimor.</p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; EVIDENCA 9.2 RREGULLORE E SEKRETARISE MESIMORE.pdf; Evidenca 39. Rregullore e zyrave studentore alumni dhe karriera.pdf; vizita në institucion]</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator të UniBa, Zyra e Rekrutimit, Pranimit & Regjistrimit planifikon, menaxhon dhe koordinon procesin e rekrutimit, aplikimit, pranimit dhe regjistrimit të studentëve të rinj.</p> <p>Zyra e Dekanit të Studentëve menaxhon dhe koordinon aktivitetet dhe shërbimet mbështetëse për mbarëvajtjen e jetës studentore, gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij. Zyra Alumni dhe Karriera është e fokusuar në procesin e orientimit dhe këshillimit të karrierës për studentët e UniBa dhe koordinimin e veprimtarive me tregun e punës.</p> <p>Sekretaria Mësimore ka si funksion regjistrimin dhe mbajtjen e bazës së të dhënave të studentëve, mbajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit lidhur me ecurinë mësimore dhe diplomimin e tyre, përgatitjen dhe dhënien e vërtetimeve dhe konfirmimeve përkatëse.</p> <p>Gjithashtu, Koordinator i Departamentit së bashku me personelin akademik të programit të studimit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, rregulloret, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ u informua se për shkak të numrit të ulët të studentëve Koordinator mbulon të gjitha programet e studimit që ofrohen nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës.</p> <p><i>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; EVIDENCA 9.2 RREGULLORE E SEKRETARISE MESIMORE.pdf; Evidenca 39. Rregullore e zyrave studentore alumni dhe karriera.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në takimin me përfaqësuesit e Zyrave të Shërbimeve Studentore, gjatë vizitës në institucon, GVJ konstatoi se në përputhje me parashikimet e kuadrin rregullator të UniBa, Dekani i studentëve dhe Zyra Alumni dhe Karriera janë dy strukturat që këshillojnë në mënyrë të vijueshme studentët për përfundimin me sukses të ciklit të studimeve dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Zyra e Dekanit të Studentëve menaxhon dhe koordinon aktivitetet dhe shërbimet mbështetëse për mbarëvajtjen e jetës studentore, gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij. Dekani i Studentëve në UniBa shërben si urë lidhëse mes studentëve, personelit akademik dhe komunitetit, në mbrojtje të interesave të studentëve dhe për garantimin e një studimi cilësor.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra Alumni dhe Karriera është e fokusuar në procesin e orientimit dhe këshillimit të karrierës për studentët e UniBa dhe koordinimin e veprimtarive me tregun e punës. Në takim, përgjegjësjë e Zyrës Alumni dhe Karriera sqaroi se aktiviteti i zyrës fokusohet në informimin e studentëve, përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe komunikimit me e-mail, mbi gjetjen e vendeve për realizimin e praktikave mësimore bazuar në marrëveshjet e lidhura nga institucioni, mbajtjen e të dhënave për punësimin e të diplomuarve, organizimin e trajnimeve për intervista pune e këshillim karriere, informimin mbi organizimin e aktiviteteve sociale të klubeve studentore (Klubi i Karrierës etj), organizimin e</p>

	<p>Panairit të Punës pranë UniBa dhe angazhimin vullnetar të studentëve në këto organizime etj. Kjo zyrë e zhvillon aktivitetin sipas një plani pune të miratuar nga Zv/Rektori i Studentëve dhe në fund të vitit harton një raport mbi aktivitetin e zyrës</p> <p>Gjithashtu, Zyra Alumni dhe Karriera ka për detyrë të mbështesë studentët e diplomuar në mënyrë që ata të orientohen dhe të përshtaten më mirë në tregun e punës. Për këtë qëllim, zyra mbledh të dhëna për të diplomuarit përmes pyetësorit për studentët alumni dhe mban një bazë të dhënash, si dhe ndjek integrimin e tyre në tregun e punës dhe mban kontakte me studentët e diplomuar me qëllim bashkëpunimin në shërbim të programeve të studimit.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; EVIDENCA 20.9 RAPORT VJETOR ALUMNI.pdf; Evidenca 39. Rregullore e zyrave studentore alumni dhe karriera.pdf; Info. Shtesë: 2.Raport Vjetor Zyra e Karrieres.pdf; 2.1. Plani Punes 2021-22 Zyra Alumni dhe Karriera.pdf; vizita në institucion]</p>						
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në dispozicion të informimit të studentëve janë Zyrat e Shërbimeve Studentore, Sekretaria Mësimore si dhe Koordinatorit i DESF dhe personeli akademik i PS. - Koordinatorit mbulon të gjitha programet e studimit që ofron DESF. - Zyra Alumni & Karriera mbledh dhe mban një bazë të dhënash për të diplomuarit përmes pyetësorit për studentët alumni. 						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VL.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. UniBa ka hartuar udhëzues për metodat e mësimdhënies, manual për hartimin/riorganizimin e një programi studimi si dhe guida për mësimdhënien online.</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 11 UDHEZUAES PER METODAT E MESIMDHENIES.pdf; EVIDENCA 11.8 MANUAL I MESIMDHENIES ONLINE.pdf; EVIDENCA 17. MANUALI I HARTIMIT TE KURRIKULAVE.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ konstatoi se monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC); ▪ Zv/Rektori për Çështjet Akademike; ▪ Zyra e Vlerësimit të Performancës; ▪ Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për programin e studimit. <p>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, pyetësorët koleg-me koleg, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe UniBa (mbledhjet përkatëse).</p> <p>Në një këndshtrim më të gjerë, monitorimi dhe vlerësimi periodik i performancës parashikohet në rregulloren me të njëtin emër të UniBa dhe përfshin edhe angazhimin e Zyrës së Burimeve Njerëzore në këtë proces. Në Kreun III të kësaj rregulloreje parashikohen procedurat dhe dokumentacioni i vlerësimit të performancës pranë UniBa.</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 16.3 FORMULAR RAPORTIMI I PUNES SEMESTRALE TE PEDAGOGUT.pdf; Evidenca 22. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Siç u përmend edhe në fushën <i>V Studentët dhe Mbështetja e tyre</i>, kuadri rregullator i UniBa u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga NJZHKC, në nivel institucioni.</p> <p>Gjithashtu, parashikohet edhe e drejta e ankimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve ose vlerësimin në provim,</p>

	<p>kundrejt një kërkesë me shkrim që i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara.</p> <p>[Referenca: EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; EVIDENCA 16.8 RAPORTI MBI REZULTATET E FORMULARIT TE STUDENTIT 21-22 SEM I.pdf; vizita në institucion]</p>		
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtjshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi se raporti vjetor i NJZHKC u paraqitet strukturave drejtuese të institucionit dhe përmes tyre informohet në mënyrë konfidenciale edhe personeli akademik me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, por nuk ndeshi ndonjë publikim të rezultateve të vlerësimeve të kryera nga kjo strukturë (në faqen web zyrtare të UniBa rezultojnë të publikuara RVB-të për programet e studimit të akredituara). Gjithashtu GVJ nuk konstatoi ndonjë shembull promovimi të praktikave pozitive me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësim të mëtjshëm në mësimdhënie.</p> <p>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Info. shtesë 1. Analiza mbi arrijten e objektivave 2019-20.pdf; 1.1. Analiza Vjetore DEFS (2 vitet fundit).pdf; https://umb.edu.al/dossier-uniba.html; vizita në institucion]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UniBa ka hartuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. - Kuadri rregullator i UniBa u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje. - Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, pyetësorët koleg-me koleg, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe UniBa (mbledhjet përkatëse). - Nuk ka publikime të rezultateve të vlerësimeve të kryera nga NJZHKC apo shembuj promovimi të praktikave pozitive me qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësim të mëtjshëm në mësimdhënie. 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi VI.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e</p>	<p>Në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, nenet 10 dhe 23 të Statutit të UniBa parashikojnë ngritjen e strukturave si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë (NJZHKC);

<p>nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>▪ Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (KSSC); si dhe hartimin, nga institucioni, të politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>KSSC (komisioni i përhershëm) mbështet dhe këshillon organet drejtuese të UniBa, si dhe lehtëson komunikimin mes strukturave të ndryshme të institucionit lidhur me politikën dhe procedurat për sigurimin e cilësisë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.</p> <p>NJZHKC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, orienton zhvillimin e kurrikulave si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë të hapësirës europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, NJZHKC kujdeset për ruajtjen e standardeve të sigurimit të cilësisë, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar efikasitetin e programeve të studimit, si dhe ndjek procesin e akreditimit të të gjitha programeve të studimit pranë UniBa, në bashkëpunim me personelin akademik të fakultetit dhe departamentit përgjegjës për programin e studimit</p> <p>Detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave përcaktohen edhe në rregulloret specifike të tyre.</p> <p>Që prej vitit 2018, institucioni ka hartuar një Strategji të Sigurimit të Cilësisë, e cila është diskutuar me të gjitha njësitë bazë dhe kryesore të UniBa.</p> <p>Në Strategjinë e zhvillimit institucional 2020-2030 parashikohen qëllime dhe objektiva në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së aktivitetit akademik dhe kërkimor që përfshijnë bashkëpunimin me studentët dhe bashkëpunëtorë të jashtëm.</p> <p><i>GVJ rekomandon përditësimin e Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë, në përputhje edhe me ndryshimet e ndodhura në nivel institucional në vitet e fundit.</i></p> <p><i>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; Evidenca 3. Strategjia e zhvillimit të institucional 2020-2030.pdf; Evidenca 5.1 Strategjia e Sigurimit të cilësisë UNIBA.pdf; Evidenca 10. Rregullore e NjZHKC.pdf; EVIDENCA 27 TABELAT 1 - 24.pdf; Evidenca 30. Rregullore e Standardeve dhe Cilësisë.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni dhe programi i studimit “Master i Shkencave në Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” i është nënshtruar procesit të akreditimit të jashtëm në bazë të parashikimeve dhe përcaktimeve ligjore. Me vendim të Bordit të Akreditimit Nr.60, datë 16.12.2021, UniBa ka marrë riakreditimin institucional me vlerësim përfundimtar pozitiv dhe me kohëzgjatje pesë vite. Ndërsa ky program studimi, si pjesë e programit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me disa profile, ka marrë fillimisht vlerësimin e akreditimit me kusht nga Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë (KA), me vendimin Nr. 67, datë 27.07.2015. Më pas, me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 604, datë 22.12.2016, programi i studimit Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me</p>

	<p>disa profile është akredituar sipas të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që buronin nga kuadri ligjor në fuqi, pasi me vendimin Nr.207, datë 18.11.2016 të KA janë konsideruar të plotësuar kushtet për akreditim të vendosura në vendimin e mëparshëm të KA.</p> <p>[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; evidenca 1.4 e Vendimi i bordit te akreditimi institucional nr 60 dt 16.12.2021.pdf; Evidenca 1.6 UMAS - MSHKF.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Siç u përmend edhe në Kriterin 2 të Standardit VI.1 monitorimi dhe vlerësimi periodik i performancës parashikohet në rregulloren “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës” të UniBa dhe përfshin edhe angazhimin e Zyrës së Burimeve Njerëzore në këtë proces. Në Kreun III të kësaj rregulloreje parashikohen procedurat dhe dokumentacioni e vlerësimit të performancës pranë UniBa.</p> <p>Pavarësisht se nuk u konstatua ndonjë promovim bazuar në mekanizmat formalë të vlerësimit të ecurisë së programeve të studimit, gjatë vizitës në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi përdorimin si instrument për matjen dhe vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pyetësorët e studentëve nëpërmjet të cilëve përfitohet informacion mbi cilësinë e programit të lëndëve, zhvillimit të procesit mësimor, cilësinë e mësimdhënies nga pedagogu dhe infrastrukturën e vënë në dispozicion të studentit. ▪ Pyetësorët koleg me koleg dhe raportimet e punës semestrale, nëpërmjet të cilëve sigurohet informacion mbi metodologjinë didaktike, marrëdhëniet me institucionin dhe kolegët, aksesin në trajnime dhe konferenca për monitorimin e kërkimit të tyre shkencor. ▪ Monitorime të procesit mësimor sipas kalendarit semestral dhe sipas cikleve të studimit. ▪ Intervistat informale me studentët dhe takime të përbashkëta me studentë dhe pedagogë të UniBa, në fund të çdo semestri, me objekt ecurinë dhe problematikat e ndeshura gjatë mësimdhënies. <p>[Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf; Evidenca 11. Formular vlerësimi të mesimdhënies kolege me kolege.pdf; EVIDENCA 16.3 FORMULAR RAPORTIMI I PUNES SEMESTRALE TE PEDAGOGUT.pdf; EVIDENCA 16.10 GUIDA PER FOKUS GRUPIN.pdf; Evidenca 22. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UniBa ka ngritur struktura dhe hartuar politika/procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. - PS është akredituar me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 604, datë 22.12.2016. - UniBa përdor kryesisht pyetësorët, raportimet semestrale dhe analiza të të dhënave në nivel departamenti dhe fakulteti për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe problematikave në mësimdhënie dhe kërkim.

Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet sërish	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi përdorimin e pyetësorëve, raportimeve semestrale dhe analizave të të dhënave në nivel departamenti dhe fakulteti si mekanizma për të siguruar informacion mbi pëmbajtjen e programit të studimit, lëndëve, cilësinë e mësimdhënies, angazhimit të personelit akademik dhe infrastrukturën në dispozicion të studentëve.</p> <p>GVJ konstatoi se mbi rezultatet e këtyre proceseve NJZHKC harton raporte specifike dhe raportin vjetor të saj, që u paraqiten strukturave drejtuese të UniBa dhe përmes tyre informohet në mënyrë konfidenciale edhe personeli akademik me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstatoi se raportet e NJZHKC kryesisht bëjnë një paraqitje përshkruese të proceseve dhe gjetjeve të tyre, por nuk përfshijnë një plan masash për përmirësim të problematikave.</p> <p><i>GVJ rekomandon që në raportet e strukturës së NJZHKC të përfshihet edhe një plan masash për përmirësimin e gjetjeve dhe rekomandime për promovimin e praktikave pozitive me qëllim nxitjen e personelit akademik dhe të studentëve për përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf; EVIDENCA 16.8 RAPORTI MBI REZULTATET E FORMULARIT TE STUDENTIT 21-22 SEM I.pdf; Info. Shtesë 1.1. Analiza Vjetore DEFS (2 vitet fundit).pdf; NjZHKC Raport 2022.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve,</p>	<p>GVJ konstaton se UniBa përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e brendshëm të cilësisë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pyetësorët e studentëve & Pyetësorët koleg me koleg; ▪ Raportimet e punës semestrale nga pedagogët; ▪ Raportimet nga NJZHKC; ▪ Monitorime të procesit mësimor dhe analiza në mbledhjet e departamentit etj;

<p>vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>nëpërmjet të cilave merr informacion mbi vlerësimin e kurrikulave, planit mësimor, metodave didaktike të mësimdhënies, vlerësimin e ecurisë dhe angazhimit të studentëve në programin e studimit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që këto metoda të pasurohen edhe me dëgjimet dhe vëzhgimet në auditor nga Profesorati, veçanërisht për pedagogët dhe kërkuesit e rinj shkencorë, si një metodë e drejtëpërdrejtë e vlerësimit dhe përmirësimit të metodave të mësimdhënies nga pedagogët e rinj.</i></p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 16.8 RAPORTI MBI REZULTATET E FORMULARIT TE STUDENTIT 21-22 SEM I.pdf; Info. Shtesë 1.1. Analiza Vjetore DEFS (2 vitet fundit).pdf; NjZhKC Raport 2022.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Në kuadër të procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UniBa përdor si instrumenta të tërthorta vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ intervistat informale me studentët (fokus grupe); ▪ pjesëmarrjen e studentëve në mbledhjet e hapura të departamentit; ▪ pyetësorin Alumni të realizuar nga zyra “Alumni & Karriera”; ▪ takimet me grupin “Barleti Business Partners” dhe bashkëpunëtorë të tjerë. <p><i>GVJ rekomandon hartimin e raporteve të dedikuara lidhur me takimet me bashkëpunëtorët e jashtëm, opinionin i të cilëve ka një vlerë të veçantë për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit veçanërisht në lidhje me përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Info. Shtesë 1.1. Analiza Vjetore DEFS (2 vitet fundit).pdf; 2.Raport Vjetor Zyra e Karrieres.pdf; 6. Barleti Business Partners - Takime.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UniBa përdor pyetësorët, raportimet semestrale dhe analiza të tjera në nivel departamenti dhe fakulteti si mekanizma për të siguruar informacion mbi përmbajtjen e programit të studimit, lëndëve, cilësinë e mësimdhënies, angazhimit të personelit akademik dhe infrastrukturën në dispozicion të studentëve. - Raportet e strukturës së NJZHKC nuk përfshijnë plan masash për përmirësimin e gjetjeve dhe rekomandime për promovimin e praktikave pozitive. - UniBa përdor metoda të drejtëpërdrejtë dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimi. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbyhet plotësisht</p>	<p>Përmbyhet kryesisht</p>	<p>Përmbyhet pjesërisht</p>	<p>Përmbyhet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.

Kuadri rregullator kryesor i UniBa, Statuti dhe Rregullorja e tij, përcaktojnë qartë organet që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimin të vazhduar të cilësisë së programit të studimit si: Senati & Autoritetet drejtuese akademike, Komisioni për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KSSC), Këshilli Studentor, si dhe Njësia për Zhvillimin Kurrikular dhe të Cilësisë (NJZHKC).

Rregullorja e KSSC dhe Rregullorja e NJZHKC bazohen në ligjin e Arsimit të Lartë dhe evidentojnë njësitë apo strukturat që përfshihen në sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe rolet që ka secila prej tyre.

[Referenca: Evidenca 1. Statuti i Universitetit Barleti.pdf; EVIDENCA 1.2 RREGULLORE UNIBA.pdf; Evidenca 10. Rregullore e NjZHKC.pdf; Evidenca 30. Rregullore e Standardeve dhe Cilesise.pdf]

Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.

Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.

Procesi i vlerësimin të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit të studimit është gjithëpërfshirës, duke përfshirë jo vetëm studentët dhe personelin akademik në dhënien e opinioneve të tyre për programin e studimit, por duke i përfshirë edhe në përbërjen e strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Një anëtar i NJZHKC është personel akademik i Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë e studimit, një student është anëtar i KSSC dhe gjithashtu disa studentë dhe pedagogë janë përfshirë në aktivitetet e NJZHKC si anëtarë të GVB-ve të programeve të studimit në proces akreditimi.

[Referenca: EVIDENCA 27 TABELAT 1 - 24.pdf]

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimin duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.

Procesi i vlerësimin të brendshëm të cilësisë është gjithëpërfshirës dhe GVJ konstaton se pyetësorët dhe instrumentet e tjerë të përdorur në këtë proces nuk çenojnë lirinë akademike dhe integritetin akademik të personelit dhe studentëve.


Strukturat e vlerësimin të brendshëm kujdesen që të shmangin çdo lloj diskriminimi duke ruajtur privatësinë e informacionit dhe rezultateve që sigurojnë nga veprimtaria e tyre dhe anonimitetin e studentëve që plotësojnë formularët e vlerësimin.

Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimin dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UniBa ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme, nga të cilat mundohet të përfitojë edhe në kuadër të konsultimeve për rritjen e cilësisë së programeve të studimit që ofron.

<p>ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Që prej vitit 2019, pranë Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës është krijuar Bordi i Karrierës me përfaqësues nga tregu i punës me objektiv bashkëpunimin me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave të programeve të studimit të ofruara nga Departamenti por edhe për integrimin e suksesshëm të studentëve të UniBa në tregun e punës. Gjithashtu, vitin e fundit është krijuar Barleti Business Partner me përfaqësues nga biznese të ndryshme me të cilët departamenti realizon takime të hapura me studentët dhe aktivitete të tjera të përbashkëta. <i>GVJ rekomandon hartimin e raporteve të dedikuara (formale) lidhur me takimet me bashkëpunëtorët e jashtëm, opinioni i të cilëve ka një vlerë të veçantë për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit veçanërisht në lidhje me përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës.</i> [Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Info. Shtesë: 6. Barleti Business Partners - Takime.pdf; 6.2. Partneritete UniBA FK.pdf; Evidenca 22. Vendim për krijimin e Bordit të Karrierës.pdf]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kuadri rregullator kryesor i UniBa, Statuti dhe Rregullorja e tij, përcaktojnë qartë organet që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimin të vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</i> - <i>UniBa siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</i> - <i>Përfshirja e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë realizohet kryesisht përmes takimeve të hapura dhe aktiviteteve të përbashkëta por mungojnë raporte të dedikuara (formale) mbi rezultatet e takimeve/aktiviteteve të zhvilluara.</i> 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushje pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstatoi se në faqen web zyrtare të institucionit ka një hapësirë të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë të interesuarve. Aty publikohet informacioni mbi strukturat e sigurimit të cilësisë në UniBa, procedurat institucionale, rregullorja e NJZHKC dhe udhëzues të përgatitur prej saj etj. Gjithashtu në faqen web zyrtare të UniBa rezultojnë të publikuara RVB-të për programet e studimit të akredituara.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të</p>	<p>GVJ konstaton se raportet e NJZHKC, përfshirë raportin vjetor, nuk janë të publikuara në faqen web zyrtare të UniBa. Por, në takimet e zhvilluara</p>



<p>studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se këto raporte u komunikohen të gjitha strukturave drejtuese të UniBa dhe diskutohen në të gjitha njësitë bazë. Gjithashtu, përmes personelit akademik dhe broshurave promovuese ky informacion dhe pjesë të strategjisë së zhvillimit të institucionit u bëhen të njohura edhe studentëve.</p> <p>GVJ konstaton se informacioni i paraqitur në këto raporte respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe ruan privatesinë e informacionit në përputhje me legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 10. Rregullore e NjZHKC.pdf; https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html; https://umb.edu.al/dossier-uniba.html; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Siç u përmend edhe në kriteret 1 &2 të Standardit VI.3, GVJ konstatoi se raportet e NJZHKC kryesisht bëjnë një paraqitje përshkruese të proceseve dhe gjetjeve të tyre, por nuk përfshijnë një plan masash për përmirësim të problematikave. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi që në UniBa plani i masave për përmirësimin e situatave të evidentuara realizohet nga strukturat drejtuese të institucionit (me vendim të Rektorit).</p> <p><i>GVJ rekomandon që në raportet e strukturës së NJZHKC të përfshihet edhe një plan masash për përmirësimin e gjetjeve si dhe rekomandime për promovimin e praktikave pozitive.</i></p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; EVIDENCA 16.8 RAPORTI MBI REZULTATET E FORMULARIT TE STUDENTIT 21-22 SEM I.pdf; Info.. Shtesë 1.1. Analiza Vjetore DEFS (2 vitet fundit).pdf; NjZHKC Raport 2022.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet gjatë vizitës në UniBa, GVJ konstaton se UniBa konsideron krijimin e kulturës së vlerësimit, përmes ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve, si kusht parësor për efektivitetin e zhvillimit të vlerësimit.</p> <p>Në mbledhjet e departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, personeli akademik analizojnë ecurinë dhe problematikën e procesit mësimor, punën kërkimore-shkencore, angazhimin administrativ, aktivitetet me studentët si dhe përcaktohen objektivat për vitin e ardhshëm akademik në funksion të përmirësimin të vijueshëm të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në planin e punës së NJZHKC për vitin përfshihen takime dhe aktivitete me personelin akademik, studentët dhe strukturat mbështetëse të UniBa me qëllim përditësimin e vijueshëm të tyre dhe për të nxitur pjesëmarrjen aktive në procesin e përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><i>[Referenca: Raporti i Vlersimit te Brendshem.pdf; Evidenca 32. Plan Pune - Zyra e NJZHKC (1).pdf; Info. Shtesë 1.1. Analiza Vjetore DEFS (2 vitet fundit).pdf; NjZHKC Raport 2022.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në faqen web zyrtare të UniBa publikohet informacion i dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë të interesuarve.

	<ul style="list-style-type: none"> - Raportet e NJZHKC kryesisht bëjnë një paraqitje përshkruese të proceseve dhe gjetjeve të tyre, por nuk përfshijnë një plan masash për përmirësim të problematikave. - NJZHKC organizon takime dhe aktivitete me personelin akademik, studentët dhe strukturat mbështetëse të UniBa në funksion të përditësimit të tyre dhe pjesëmarrjes aktive në procesin e përmirësimit të cilësisë. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Kontabilitet-Financë” me profil “Kontabilitet” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Infrastruktura fizike dhe organizative e përshtatshme për një proces mësimor efektiv, krahasuar edhe me numrin aktual të studentëve.
2. Personel akademik i përkushtuar dhe i kualifikuar për një mësimdhënie cilësore.
3. Mbështetja ndaj studentëve përmes politikave të bursave dhe aktiviteteve të klubeve studentore.
4. Mbështetja nga Institutet dhe Qendrat kërkimore të Grupit Barleti, mundësojnë një aktivitet kërkimor ndërdisiplinor dhe bashkëpunime me ekspertë të mirënjohur të fushave përkatëse.

Pika të dobëta:

1. Angazhim i personelit akademik me kualifikime Msc në këtë program studimi. [Referenca: Fusha II, Standardi II.2; Fusha III, Standardi III.1]

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

2. Qendrueshmëria relative e personelit akademik në këtë program studimi. [Referenca: Fusha IV, Standardi IV.1]
3. Ndryshime në programin mësimor, jo të dokumentuara plotësisht dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. [Referenca: Fusha II, Standardi II.3; Fusha III, Standardi III.1]
4. Rregullorja e Departamentit dhe Rregullorja e Programit të Studimit janë shumë të përgjithshme lidhur me fushat e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon departamenti. [Referenca: Fusha I, Standardi I.1; Fusha II, Standardi II.1]
5. Mungesa e raporteve të dedikuara të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe nga aktivitetet me aktorët e jashtëm në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës së programeve të studimit. [Referenca: Fusha VI, Standardi VI.4]
6. Mungesa e analizave të detajuara lidhur me kostot akademike dhe logjistike sipas programeve të studimit apo sipas cikleve të studimit. [Referenca: Fusha IV, Standardi IV.5]

Rekomandime:

1. UniBa duhet t'i kushtojë vëmendje të angazhimit të një personeli akademik të qendrueshëm dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për programet master.
2. Ndryshimet në programet mësimore duhet të formalizohen në mënyrë të plotë dhe sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.
3. Emërtimet e disa lëndëve në programin mësimor duhet të përditësohen në përputhje me ciklin e studimeve, duhet të parashikohen orë laboratorike të detyrueshme, si dhe duhet të përfshihen në programin mësimor lëndë me zgjedhje si psh nga fusha e sistemeve të informacionit dhe fusha e financës.
4. UniBa duhet të përditësojë Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e Programit të Studimit me përcaktime më të plota në funksion të natyrës specifike të programeve të studimit dhe aktivitetit kërkimor që mbulon departamenti.
5. Institucioni duhet të hartojë raporte të dedikuara të përfitimeve/kontributeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe nga aktivitetet me aktorët e jashtëm në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës së programeve të studimit.
6. Institucioni duhet të realizojë një analizë të qartë dhe të detajuar lidhur me kostot akademike dhe logjistike sipas programeve të studimit apo sipas cikleve të studimit.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Accounting – Finance" with profile "Accounting" provided by the Higher Education Institution "Barleti University"

Strengths and affirmations

1. The physical and organizational infrastructure suitable for an effective learning process, compared to the current number of students.
2. the commitment and expertise of the academic staff engaged at the study program.
3. Support provided to students through scholarship policies and student club activities.
4. Institutes and Research Centers of the Barleti Group ensure and enable interdisciplinary research activity and collaborations with well-known experts in their respective fields.

Weaknesses

1. Engagement of academic staff with Msc qualifications in this study program. *[Reference: Chapter II, Standard II.2; Chapter III, Standard III.1]*
2. The relative stability of the academic staff in this study program *[Reference: Chapter IV, Standard IV.1]*
3. Changes in the curriculum, not fully documented and in accordance with the requirements of the regulatory framework in force. *[Reference: Chapter II, Standard II.3; Chapter III, Standard III.1]*
4. The Department Regulations and Study Program Regulations broadly define the general and specific areas of the study program and of the research activity covered by the department. *[Reference: Chapter I, Standard I.1; Chapter II, Standard II.1]*
5. Lack of dedicated reports of benefits from cooperation agreements and activities with external actors in function of continuous improvement of the curriculum of study programs. *[Reference: Chapter VI, Standard VI.4]*
6. Lack of detailed analysis related to academic and logistical costs according to study programs and/or according to study cycles. *[Reference: Chapter IV, Standard IV.5]*

Recommendation

1. UniBa must pay attention to the recruitment of a stable academic staff in accordance with the requirements of the current regulatory framework for master's degree programs.
2. Changes in the curriculum of the study program must be formalized in full and according to the provisions of the current regulatory framework.
3. The names of some courses in the curriculum should be updated in accordance with the study cycle (master's degree). In addition, the curriculum should include mandatory practice hours for IT based courses and should include elective courses, for example in information systems and finance.
4. UniBa should update the Department Regulations and Study Program Regulations with more complete definitions in view of the specific nature of the study programs and research activity covered by the department.

5. The institution should draw up dedicated reports of benefits/contributions from cooperation agreements and from activities with external actors, for the continuous improvement of the curriculum of the study programs.
6. The institution should carry out a clear and detailed analysis regarding the academic and logistical costs according to the study programs or according to the cycle of studies.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përmbushen plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

80